

Ana tjetër e medaljes

PËRVOJA GJEOPOLITIKE E FARKUAR NË KOSOVË

Kosova do të vazhdojë të mbetet me një status të kombinuar, pavarësi-jopavarësi, ose me një protektorat të modifikuar, sipas kalkulimeve të fituesit të luftës së Kosovës në vitin 1999. Prandaj, edhe nga ky aspekt, Kosova do të sjellë një përvojë të re gjeopolitike.



Milazim KRASNIQI



Kosova duket se është e destinuar të jetë vendi në të cilin ballafaqohen dhe ndërrohen pozitat gjeopolitike të Fuqive të Mëdha nëpër shekuj. Ia vlen të bëhet këtu një përkujtesë e shkurtër argumentuese: në vitin 1389 fitorja e Perandorisë Osmane kundër serbëve, e solli një ndryshim gjeopolitik, i cili për pesë shekuj e mbajti prezent dhe me ndikim Perandorinë Osmane dhe Hilafetin në thellësi të truallit europian. Historia e kontinentit të vjetër është e pamundur të shkruhet e plotë pa përfshirjen e ndikimit që pati Perandoria Osmane në fatet e saj, luftërat dhe paqen që e përshkoi jetën e kontinentit për pesë shekuj. Nga kjo rezulton se Beteja në Kosovë e vitit 1389, nuk ka të bëjë vetëm me historinë serbe e atë shqiptare, po me tërë historinë europiane.

Riokupimi serb i Kosovës në vitin 1912, po ashtu solli ndryshime të thella gjeopolitike. E inkurajuar nga fitorja dhe masakrat kundër shqiptarëve, Serbia nuk mundi të ndalej, prandaj përfundoi në konflikt ushtarak edhe me Bullgarinë, aleatin e saj në Luftën e Parë Ballkanike.

Edhe atentati terrorist serb në Sarajevë kundër dukës Franc Ferdinandit, që i parapriu kasaphanës së Luftës së Parë Botërore, mund të thuhet se bazën ideologjike e pati te mitologjia serbomadhe e prodhuar mbi mitin e Betejës së Kosovës dhe te përlligjja e riokupimit të Kosovës.

Në shënimin e gjashtë qindvjetorit të Betejës së Kosovës, në vitin 1989, po në Kosovë u valëvitën sërish flamujt e luftërave, që do të sillnin ndryshime të thella gjeopolitike në Ballkan. Në mitingun e 28 qershorit 1989, Slobodan Milosheviqi shpалosi idetë e luftërave të reja për krijimin e Serbisë së Madhe, të cilat i filloi dhe i përfundoi vetë. Ndërsa, në vitin 1999, intervenimi ushtarak i NATO-s mundësoi dëbimin e forcave serbe edhe nga Kosova dhe krijimin e një tabloje krejt të re gjeopolitike në Ballkan. Por, ky realiteti i ri nuk është përmbyllur ende.

Statusi i pazgjidhur i Kosovës po vazhdon të shfrytëzohet nga Rusia, në përpjekjet e saj për ta rikthyer ndikimin e vet në hapësirat ballkanike. Kërcënimi i Ruisë me veto në Këshillin e Sigurimit kundër pavarësisë së Kosovës, më shumë se me synimet imperiale ndaj Gjeorgjisë e

Moldavisë, ka të bëjë me përpjekjet për ta mbajtur, së paku në kuotat minimale idenë rusifikuese në Ballkan. Pas pranimi në NATO dhe në Bashkimin Europian të Bullgarisë, Rusia të vetmen shpresë se do ta mbajë gjallë idenë rusifikuese në Ballkan e ka në Serbi. Historia e gjatë e pansllavizmit dhe e panortodoksizmit në Serbi është ende shumë aktive. Kjo histori ka prodhuar edhe propozime idiotike në ndonjë rast si në vitin 1999, kur nga qeveritarë të atëhershëm, u propozua krijimi i konfederatës serbo-bjelloruse, nën ombrellën e Ruisë. Por, atë ombrellë e prishën bombat e NATO-s. Duke i pasur të qarta këto prire retrograde të politikës serbe, Rusia po përpiqet ta shfrytëzojë Serbinë në pretendimet e saj të presionit mbi Perëndimin.

Shikuar në këtë kontekst, Kosova është guri i fundit i dominosë, e cila e nxjerrë përfundimisht nga loja prezencën e Ruisë në Ballkan. Pavarësimi i Kosovës, pas pavarësimit të Malit të Zi, e lë prapa vetes një Serbi joimperiale, e cila nuk ka më në dispozicion asnjë alternativë përveç integritet në strukturat euro-atlantike. Kësisoj, roli i Kosovës në lojërat e reja gjeopolitike, që nisën në vitin 1989 në Gazimestan dhe kundër frymës luftënxitëse që u proklamua në Gazimestan, ende është i ndjeshëm. Pavarësia e Kosovës, prandaj do të vjen si rezultat i epërsisë së fituar gjeopolitike të Perëndimit ndaj Ruisë dhe ndaj Serbisë, si sateliti më fanatik i saj.

Po të ishte pavarësia e Kosovës si rezultat i të drejtës së popullit të saj për vetëvendosje, e jo i lojërave gjeopolitike, ajo do të pranohej nga Komisioni i Badenterit, i cili e zyrtarizoi shpërbërjen e ish Jugo-sllavisë. Nëse jo Komisioni i Badenterit, atëherë organizata botërore do ta pranonte të drejtën e popullit të Kosovës për vetëvendosje, pas spastrimit etnik dhe gjenocidit që zbatoi shteti serb kundër popullit shumicë të Kosovës. Por, kjo e drejtë nuk është pranuar dhe duket se nuk do të pranohet në mënyrë eksplicite as në raportin e Marti Ahtisarit. Kosova do të vazhdojë të mbetet me një status të kombinuar, pavarësi-jopavarësi, ose me një protektorat të modifikuar, sipas kalkulimeve të fituesit të luftës së Kosovës në vitin 1999. Prandaj, edhe nga ky aspekt, Kosova do të sjellë një përvojë të re gjeopolitike.

Por, edhe kësaj here do të ndodh e njëjta gjë me vullnetin e popullit të saj: ai do të respektohet aq sa nuk i prish punë "prezencës ndërkombëtare", e cila e ka zëvendësuar okupatorin serb. Por, jo më shumë.

Botohet nga O.J.Q.
"Zëri Ynë"

Redaksia

Drejtor:
Muhamed Jusufi -
KAJOLLI

Redaktor përgjegjës:
Shkelzen NUZA

Redaktor gjuhësor:
Mimoza SINANI

Redaktor teknik/Grafika:
Osman D. GASHI

Anëtarët e redaksisë:
Arber ZEKA
Ilir DESKU
Nexhati SPAHIU
Mergim LUSHTAKU

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
revistapaqja@yahoo.com

Adresa:
Xhavit Mitrovica, nr. 14
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Kontakti:
+377 44 418 935
+377 44 637 111
+377 44 633 281

Intervistë me Dr. Ferid Aganin, pedagog në Universitetin e Prishtinës dhe deputet në Kuvendin e Kosovës

PROBLEMET E QYTETARËVE TË KOSOVËS NUK JANË PRORITET I STRUKTURAVE QEVERISËSE

Në intervistën ekskluzive për revistën Paqja, Dr. Ferid Agani, pedagog në Universitetin e Prishtinës dhe deputet në Kuvendin e Kosovës thotë se probleme reale janë: zgjidhja e problemeve të pensionistëve, të invalidëve, të dëshmorëve, të jetimëve, të personave me aftësi të kufizuara dhe të kategorive të tjera të popullatës, të cilët janë më nevojtarë për ndihmën e institucioneve shtetërore.



PAQJA: Me cilat probleme ballafaqohet më së shumti rinia jonë sot?

F. Agani: Problemet e rinisë sot janë të shumta dhe të shumëllojshme. Në radhë të parë këto probleme kushtëzohen nga procesi i shkollimit. Në objektet shkollore mësimin e vijnë një numër tepër i madh i nxënësve. Tekstet shkollore janë ende të mangëta dhe jo kualitative; profesorët dhe arsimtarët e ç'motivuar nga pagat e ulëta, janë tejet të ngarkuar me norma të mëdha të orëve mësimore dhe me një numër të madh të nxënësve në klasë. Krejt këto bëjnë që procesi mësimor të mos ketë kualitetin e duhur dhe natyrisht edhe procesi i nxënies së materialit mësimor të mos jetë në nivelin e duhur.

Së dyti, rinia jonë ballafaqohet me problemin serioz të mungesës së aktiviteteve të organizuara kulturore, edukative, sportive dhe të tjera, në kohën e lirë. Këto aktivitete janë pjesë qenësore e procesit të ndërtimit të personalitetit të të rinjve sepse me to, veç të tjerash, ndërtohen edhe rrjetat e bashkëpunimit ndërmjet rinisë dhe gjeneratave të tjera brenda shoqërisë. Segmenti i tretë i rrethanave që kushtëzojnë vështirësitë në funksionimin social dhe psikologjik të të rinjve është preokupimi i tyre me mungesën e perspektivës për të ardhmen, duke pasur parasysh faktin se shumë prej tyre edhe pas përfundimit të studimeve nuk kanë mundësi të punësohen, gjë që shkakton shkallë të lartë të pasigurisë; ulje të vetëbesimit dhe të vetë-respektit.

PAQJA: Cilat janë masat parandaluese për mbrojtjen e rinisë nga aspekti psikologjik?

F. Agani: Në radhë të parë është i domo-


sdoshëm aktiviteti sistematik institucional në drejtim të përpilimit dhe zhvillimit të programeve gjithëpërfshirëse shtetërore që do të kenë për qëllim përmirësimin e kualitetit të mësimin në të gjitha nivelet e shkollimit, deri te ai universitar. Kjo mund të arrihet duke rritur numrin e objekteve mësimore, duke i përmirësuar kushtet e mësimin, duke e shtuar numrin dhe kualitetin e mësimdhënësve dhe duke e bërë rishkrimin e planprogrameve mësimore. Siç e thash më parë janë të domosdoshme programet e organizuara rreth aktiviteteve të lira, që kanë për qëllim socializimin e rinisë, siç janë programet kulturore, edukative, sportive dhe të tjera. Në këtë drejtim duhet investuar në ndërtimin e objekteve përkatëse. Me këtë rast, do të kisha theksuar nevojën e organizimit të aktiviteteve të organizuara që kanë për qëllim ripërtëritjen shpirtërore të rinisë

Si rezultat i mangësive të lartpërmendura, rinia është e ballafaquar me stres kronik gjatë procesit mësimor, vakum në kohën e saj të lirë dhe pa-perspektivë sa i përket të ardhmes. Në këto rrethana, të rinjtë kanë vështirësi që të arrijnë ekuilibrin e brendshëm psikologjik, veçanërisht në rrethanat e mos-ekuilibrimit ndaj elementit të tyre shpirtëror. Fatkeqësisht, programet arsimore në shkollat tona kanë ruajtur komponentin e

fuqishëm ateist dhe në mënyrë sistematike mësohet aspekti material i shoqërisë njerëzore, ndërsa për nevojën e përkujdesjes për qenien shpirtërore të njeriut mësohet shumë pak, gati asgjë. Si rezultat i mungesës së njohurive elementare lidhur me aspektet shpirtërore të funksionimit të tyre, të rinjtë janë të hutuar kur është në pyetje identiteti i tyre shpirtëror.

PAQJA: A mendoni se problemet sociale janë ndër shkaqet kryesore të rritjes së kriminalitetit?

F. Agani: Mendoj se problemet sociale lehtësojnë paraqitjen e formave devijuese të sjelljes, që janë rezultat i shkarkimit të pakontrolluar të agresivitetit, pra ata janë faktorë lehtësues, por nuk mendoj se janë faktorë kryesorë. Në këtë aspekt, rëndësi parësore ka struktura psikologjike dhe biologjike e personalitetit të njeriut.



PAQJA: Çfarë mund të na thoni për luftën e fundit në Kosovë dhe cilat janë pasojat psikike të saj?

F. Agani: Hulumtimi i fundit, të cilin e kam realizuar në tetor dhe nëntor të vitit 2005, së bashku me disa kolegë



**KORRUPSIONI,
krim në çdo gjuhë të botës:**

1. Shpinën ma ledhato, ta ledhatoj ty (**Anglisht**), 2. Mito (**Spanjisht**),
3. Mitoja, ibrig vere (**Frenjisht**), 4. Rushfet (**Arabisht**), 5. Mito (**Kinezisht**),
6. Nuk ngitet vetura pa vaj (**Rusisht**), 7. Dora, dorën e pastron (**Italisht**),
8. Më shiko, të të shikoj ty (**Turqisht**), 9. A ka formë tjetër (**Portugalisht**),
10. Paguaj me gjithë ç'ke (**Svahilisht**)

vendorë dhe ndërkombëtarë ka qenë hulumtimi i tretë i gjendjes së shëndetit mendor të popullatës së Kosovës, mbas luftës. Hulumtimi ka përfshirë 1161 qytetarë të Kosovës, prej moshës 15 vjeçare e lart. Ky hulumtim ka treguar se popullata e Kosovës ende lëngon nga pasojat e rënda të traumave psikike të lidhura me luftën e fundit në Kosovë. Konkretisht, 23% e kësaj popullate ende manifeston shenja dhe simptoma të çrregullimit të stresit post-traumatik, që është pasoja më e rëndë psikologjike e lidhur me traumat e luftës; i njëjti hulumtim ka treguar se 41.8% e kësaj popullate manifeston shenja të depressionit, ndërsa 43.1% manifeston shenja të ankthit ose të distresit emocional.

PAQJA: Çka mendoni për dukuritë negative në shoqërinë kosovare, e në veçanti tek rinia e Kosovës? Kush janë shkaktarët dhe cilët faktorë janë të ndërlidhur me këto dukuri?

F. Agani: Faktorët të cilët e kanë predisponuar një pjesë të popullatës së Kosovës për devijime serioze në strukturën e saj të vlerave dhe të normave sociale janë të shumtë dhe të nduarnduartë. Ndër ta do të kisha veçuar, periudhën e gjatë të jetesës në rrethanat e

stresit kronik psiko-social, të okupimit para luftës; traumat e rënda të përjetuara gjatë luftës; procesin shumë të vështirë të ripërtëritjes pas luftës dhe rrethanat e krizës së madhe ekonomike dhe sociale me shkallët më të larta të papunësisë dhe të varfërisë në Evropë. Faktor specifik që përcakton përhapjen më të shpejtë të dukurive negative në mesin e të rinjve të Kosovës është struktura demografike, në të cilën mbi 52% e popullatës është nën moshën 16 vjeçare; pra kemi një popullatë shumë të re, popullatën më të re në Evropë. Tranzicioni kulturor nëpër të cilin po kalon shoqëria kosovare e pasluftës si pjesë normale e procesit botëror të globalizimit është i përshpejtuar me prezencën e numrit të madh të ndërkombehtarëve në Kosovë, si civilë ashtu edhe ushtarakë, dhe është i ndërlikuar me rrethanat shumë të vështira sociale, ekonomike dhe psikologjike. Këto kanë bërë që procesi i globalizimit, që përndryshe ofron shumë mundësi, të paraqitet me aspektet e tij negative. Është e kuptueshme që rinia si pjesë e shoqërisë me veçori dhe nevoja specifike psikologjike, sociale dhe arsimore-edukative është më vulnerable ndaj këtyre zhvillimeve të pakontrolluara nga ana e institucioneve shtetërore. Prandaj, paraqitja e sjelljeve

devijuese dhe dukurive negative siç janë: narkomania, alkoolizmi, prostitucioni, deri te fenomenet më serioze të vrasjeve dhe të vetëvrasjeve që janë në rritje, veçanërisht në mesin e të rinjve, nuk është e papritur dhe për t'u befusuar.

PAQJA: Çfarë mund të na thoni për disa të rinj tek të cilët është në rritje përkushtimi ndaj fesë?

F. Agani: Rrethanat e krizës së përgjithshme shoqërore dhe anashkalimi nga ana e institucioneve shtetërore, për të cilat i thashë disa fjalë, krijojnë parakushte për kriza të aspekteve të ndryshme identifikuese të personalitetit. Kthimi drejt shpirtërores në këto rrethana është plotësisht i kuptueshëm dhe mekanizëm i natyrshëm mbrojtës i personalitetit. Ky kthim në individë të ndryshëm zhvillohet me shpejtësi dhe kualitet të ndryshëm, varësisht nga struktura psikologjike e personaliteteve të tyre. Mendoj se është bërë një hap i rëndësishëm në kuptimin e ofertës së literaturës kualitative fetare në gjuhën shqipe. Kjo literaturë në masë të madhe ka parandaluar zhvillimet e skajshme në këtë aspekt. Ripërtëritja shpirtërore, që është e evidente në mesin e rinisë sonë është për t'u përshëndetur dhe me siguri paraqet

faktorë stabilizues në shoqërinë tonë. Ajo që dua të theksoj me këtë rast është se ky rikthim drejt identitetit fetar nuk guxon të jetë i çrrënjësor nga kultura jonë kombëtare. Populli shqiptar, identitetin e tij fetar gjithmonë e ka përjetuar të ndërlidhur ngushtë me identitetin e tij kombëtar dhe kulturor. Ky fakt për mua paraqet kualitet të jashtëzakonshëm tek populli shqiptar, sepse siç është e theksuar në Kur'anin famëlartë, Allahu i Madhërishtëm na ka krijuar si popuj të ndryshëm në mënyrë që të njihemi më mirë në mes vete. Në asnjë moment nuk guxojmë të harrojmë se kulturën kombëtare duhet ta kultivojmë dhe pasurojmë në mënyrë të vazhdueshme krahas pasurimit të vazhdueshëm të identitetit tonë fetar. Derisa identiteti ynë fetar të jetë i mishëruar me identitetin tonë kombëtarë, rikthimi në besimin e sinqertë tek Zoti i Madhërishtëm do të paraqesë faktorë të jashtëzakonshëm për stabilitetin e proceseve shoqërore në Kosovë. Megjithatë, më duhet të konstatoj se numri në rritje i të rinjve, që ka filluar të kthehet në besim, megjithatë është shumë i vogël në krahasim me masën e madhe të rinisë që jeton në Kosovë. Është detyrë e të gjithëve, që të ndërmerren të gjitha masat në mënyrë që dija e kulluar dhe udhëzimet e sakta për jetë, që na vijnë prej Zotit të Madhërishtëm, të arrijnë deri te kjo masë e madhe e të rinjve.

PAQJA: Pasi që jeni edhe deputet në parlamentin e Kosovës, si e vlerësoni punën e qeverisë aktuale?

F. Agani: Po, unë e përfaqësoj Partinë e Drejtësisë në Kuvendin e Kosovës dhe kam qenë mjaft kritik ndaj kësaj dhe qeverive paraprake për punën që e kanë bërë, ose më mirë thënë që nuk e kanë bërë. Jam i bindur se qeveria, përkundër kufizimeve që i ka pasur, sa i përket kompetencave, me një politikë më të mirë shtetërore dhe me një angazhim më të sinqertë për problemet reale të popullatës ka mundur të bëjë shumë më tepër. Kur flas për problemet reale unë mendoj, në radhë të parë, në zgjidhjen e problemeve të pensionistëve, të invalidëve, të dëshmorëve, të jetimëve, të personave me aftësi të kufizuara dhe të kategorive të tjera të popullatës, të cilët janë më nevojtarët për ndihmën e institucioneve shtetërore.

Mendoj se, për fat të keq, ata nuk kanë qenë prioritet i strukturave qeverisëse në Kosovë, si atyre vendore ashtu edhe atyre ndërkombëtare. Me këtë është bërë politikë e padrejtë ndaj shtresave më të

varfra dhe më nevojtare të popullatës.

PAQJA: A mendoni se Rusia do të jetë një pengesë në Këshillin e Sigurimit për zgjidhjen e statusit të Kosovës?

F. Agani: Me siguri se do të jetë deri në një masë dhe deri në një moment të



caktuar. Në momentin kur do të sigurohet masa kritike e shteteve të cilat do ta njohim pavarësinë e Kosovës, dhe unë pres që kjo të ndodhë brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore, atëherë edhe Rusia do të lëshojë pe dhe do t'i adaptohet realitetit të krijuar në interes të stabilitetit dhe paqes në rajon.

PAQJA: Cili është mesazhi juaj për popullin, e në veçanti për rininë?

F. Agani: Mesazhi im është, që asnjëherë të mos e harrojmë qenien tonë shpirtërore dhe nevojën e bindjes së sinqertë ndaj Krijuesit të gjithësisë, ALLAHUT të Gjithëmëshirshëm, Mëshirëplotë. Mos të harrojmë se jemi njerëz të cilët nuk përbëhemi vetëm nga materia, por që kemi edhe shpirtin si pjesën më të çmuar. E vetmja mënyrë e përkujdesjes ndaj shpirtit tonë është devotshmëria ndaj Zotit të madhërishtëm dhe jeta sipas udhëzimeve të Tij. Nëse ne punojmë dhe veprojmë sipas këtyre udhëzimeve, me siguri se do të jemi në rrugë të sigurt për ndërtimin e shtetit të fuqishëm të Kosovës, që brenda një kohe të shkurtër do të arrijë të integrohet në Bashkësinë e Shteteve Evropiane dhe strukturat veriatlantike me tërë pasurinë e vlerave të tij kulturore dhe kombëtare. Në shtetin e Kosovës dukuritë negative do të ishin vetëm raste individuale dhe kurrsesi dukuri në masë, siç kërcënojnë të jenë sot.

Intervistoi **Nexhati Spahiu**

Procesi i privatizimit në Kosovë

KOMPLEKSI TU VICA", DO TË PR PASI TË ZGJIDH KOSOVËS

Ndonëse procesi i privatizimit ka pasur baticë dhe zbaticë, udhëheqësit e shtyllës së IV-të të UNMIK-ut dhe ata të AKM-së, e kanë quajtur si të përmbyllur me sukses procesin e privatizimit. Në konferencën e fundit për vitin 2006, zyrtarët e AKM-së, pohuan se kanë arritur të privatizojnë një pjesë të ndërmarrjeve shoqërore, edhe pse kanë dështuar t'i privatizojnë disa ndërmarrje, siç është rasti i Kompleksit Turistik "Brezovica", që gjendet në territorin e komunës së Shtërpcës, e banuar kryesisht me shumicë serbe, e që ishte paraparë të privatizohej gjatë vitit 2006, nëpërmjet spin-off special. Por pas presioneve të udhëheqjes së komunës së Shtërpcës dhe të Qeverisë së Serbisë, në AKM kanë vendosur që Kompleksi Turistik "Brezovica", të mos privatizohet deri sa të zgjidhet statusi i Kosovës.

Zyrtarët e AKM-së arsyetohen se një vendim i tillë është marrë në Nju-Jork, pasi ka pasur kundërshtime nga komuniteti lokal. Kjo do të thotë se procesi i privatizimit në Kosovë është nën ndikimin politik. Zyrtarët e AKM-së kanë thënë se janë krijuar 2.600 vende të reja pune, ndërsa sipas ecurisë së procesit, shumë shpejt do të hapen edhe 3.600 vende të reja pune.

Pol Akda, shef i shtyllës së IV të UNMIK-ut, ka thënë se AKM-ja vetëm gjatë vitit 2006, ka privatizuar një numër të konsiderueshëm të ndërmarrjeve shoqërore, si "Feronikeli", hotelin "Grand", "Veraria e Rahovecit" dhe "Birraria e Pejës", e shumë të tjera. Për dy të parat ka pasur pakënaqësi gjatë tenderimit të tyre. Në rastin e privatizimit të "Feronikelit", ndërmarrja i është shitur fituesit të dytë, e jo të parit, pasi që bordi i AKM-së e ka vlerësuar më serioz se të parin, edhe pse ai kishte ofruar shumë më të ulët parash se fituesi i parë. Pol Akda, po ashtu, ka përmendur edhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të vendeve të Evropës Qendrore (CEFTA), projekt i Ministrisë së Energjisë dhe Minierave për ndërtimin e termocentralit "Kosova C", si dhe shndërrimin e Autoritetit të Bankave dhe Pagesave, në

në vitin 2006

RISTIK “BREZO IVATIZOHET ET STATUSI

Autoritet Qendror Bankar, të cilat ai i ka quajtur të suksesshme. Me nënshkrimin e Marrëveshjes për Tregtinë e Lirë, Kosova është bërë anëtare e CEFTA-s, ku prodhuesit vendorë do të kenë një treg më të madh prej 30 milionë konsumatorësh. Në konferencën e fundit për vitin 2006, drejtori i AKM-së, Xhasper Dik, ka thënë se nga shitja e ndërmarrjeve shoqërore në Fondin e Mirëbesimit janë grumbulluar 256 milionë euro. Sipas tij, gjatë vitit 2006 janë nënshkruar 126 kontrata për ndërmarrjet e privatizuara. Kurse 91 kontrata janë në proces të nënshkrimit, ndërsa janë inkasuar 154 milion euro, prej tyre 9 milion janë paguar në emër të 20 përqindëshit, ku vetëm në muajt e fundit të vitit 2006 janë paguar 5 milionë euro për punëtorët në emër të 20 përqindëshit.

Parat e grumbulluara nga shitja e ndërmarrjeve kosovare, e që ruhen në “Fondin e Mirëbesimit” jashtë Kosovës të themeluar nga AKM-ja, do të ishte më mirë që të ruheshin në bankat që veprojnë në Kosovë dhe të shfrytëzoheshin nga ato dhe biznesmenët, gjë që do të ndikonte në uljen e papunësisë dhe të varfërisë në Kosovë.

Illir Salihu, zëvendës-drejtor i AKM-së dhe drejtor i ndërmarrjeve publike, ka thënë se AKM-ja i ka pasur tri objektiva për vitin 2006 që janë plotësuar. “Përfundimi i procesit të korporatizimit për ndërmarrjet kryesore publike, fillimi i korporatizimit për ndërmarrjet e ujërave dhe mbeturinave, si dhe kosovarizimi i menaxhimit të ndërmarrjeve publike.” Sipas tij, është arritur një progres në realizimin e tri synimeve të theksuara, ku ka përfunduar korporatizimi i ndërmarrjeve publike, si PTK-ja, Aeroporti, KEK-u, Hekurudhat dhe Ngrohtorja, që tash funksionojnë si korporata me struktura ligjore, financiare dhe qeverisëse, të përcaktuara qartë dhe të bazuara në parimet e OECD-së.

Përgatiti: **Lulzim AHMETI**

Postmodernia te shqiptarët II

“KATËR FAZAT E FOTOGRAFISË” DHE REALITETI POLITIK NË KOSOVË

Vdekja e kryetarit të LDK-së (njëherësh edhe president vendi) edhe pse jo ende *'de jure'*, por *'de fakto'* e ka përçarë këtë parti dhe kjo u vërejt fill pas heqjes së krye-parlamentarit Nexhat Daci, e që epilogun e mori jo vetëm në ndarjen më dysh të fraksioneve, por edhe me luftën e pakompromis për ndarjen e posteve. Kështu që lufta për karrige u shndërrua edhe në luftë me karrige.

Avni AVDIU

Filozofi postmodern Zhan Bodrijar përcaktoi katër fazat suksesive të shenjës ose fotografisë, se: 1) paraqet pasqyrimin e realitetit bazik 2) e fsheh dhe e çformëson realitetin bazik 3) ndërpret mungesën e realitetit bazik dhe 4) nuk është në asnjë lidhje me çfarëdo qoftë realiteti, është simulakrum i pastër në vete. Këto faza kanë të bëjnë me largimin suksesiv të shenjës ose fotografisë nga objekti i prezantimit, kështu që ato bëhen simulakrum i pastër në vete, virtualitet i pazbërthyes.

Zgjedhjet e para demokratike të pasluftës sollën me shumicë dërrmuese votash sërish LDK-n, e cila pasi që në kuvend nuk ia arriti ta sigurojë kuotën e caktuar për zgjedhjen e presidentit

Konceptimi i këtyllë i Bodrijarit për 'katër fazat e fotografisë', pothuajse në mënyrë të përkryer, bartet në terrenin e politikës në Kosovë. Ardhja në krye të qeverisë e personave që njiheshin si struktura civile politike e UÇK-së, menjëherë pas përfundimit të luftës, manifestonte pasqyrimin e realitetit bazik'. Zgjedhjet e para demokratike të pasluftës sollën me shumicë dërrmuese votash sërish LDK-n, e cila pasi që në kuvend nuk ia arriti ta sigurojë kuotën e caktuar për zgjedhjen e presidentit, u detyrua që si kompromis të pranojë kryeministrin opozitar, respektivisht qeverinë e unitetit me Bajram Rexhepin në krye. Pra kjo në njëfarë mënyre e 'fshehu dhe e deformato realitetin bazik'. Në zgjedhjet e dyta, pas fitores rishtas të LDK-së por kësaj radhe me më pak vota se herën e parë, kjo parti u përcaktua që të hyjë në koalicion me AAK-n, e cila kishte elitën e saj me disa

emra të njohur të udhëheqjes së luftës. Pas ca muajsh brenda AAK-së ndodhi 'tërmeti që e dridhi këtë parti'. Kryetari i saj, njëherësh kryeministër Ramush Haradinaj u akuzua nga Haga si kriminel lufte. Fatin në fatkeqësinë e tij e gjeti Bajram Kosumi, i cili nuk dihej se si dirigjohej dhe në çfarë diktati ishte.

Kështu 'u ndërpre mungesa e realitetit bazik'. Vdekja e kryetarit të LDK-së (njëherësh edhe president vendi) edhe pse jo ende *'de jure'*, por *'de fakto'* e ka përçarë këtë parti dhe kjo u vërejt fill pas heqjes së kryeparlamentarit Nexhat Daci, e që epilogun e mori jo vetëm në ndarjen më dysh të fraksioneve, por edhe me luftën e pakompromis për ndarjen e posteve. Kështu që lufta për karrige u shndërrua edhe në luftë me karrige.

AAK hoqi kryeministrin 'kukull', që ishte edhe ashtu i përfolur nga disa media për afera e skandale. Për ta ngritur rejtingun partiak dhe për të ruajtur ekuilibrin e koalicionit me LDK-n, AAK-ja solli në postin e kryeministrit Agim Çekun i njohur si 'dorë e hekurt', ish gjeneral-lejtnant i TMK-së, prestigji i të cilit gjithnjë e më shumë ngrihej në sondazhet e opinionit publik, por edhe jashtë vendit.

LDK, tash pa figurën karizmatike të Rugovës, sikur u ndie se po dobësohej, duke pasur parasysh edhe fërkimet dhe përçarjet e shumta në prag të zgjedhjeve brendapartiake. Për të forcuar pozicionin e vet në qeveri, kryesia e kësaj partie i drejtoi një letër kryeministrit Agim Çeku, përmes së cilës i kërkonte që zëvendës-kryeministri (i LDK-së Lutfi Haziri) të mbikëqyrë dhe të udhëheqë punën e ministrave të qeverisë që përfaqësojnë LDK-në, dhe po ashtu e autorizoi të bëjë vlerësime dhe rekomandime sipas nevojës së LDK-së ➔

Kështu si njëra, ashtu edhe tjetra parti e koalicionit qeveritar, u shkëputën nga çfarëdo qoftë realiteti: 'secila për vete në vete u bën simulakrum i pastër i vetes së tyre'.

(Pika 2 e letrës). Edhe të gjitha katër pikat tjera e vetëlegjitimojnë LDK-në, si për të prirë procesin politik të zhvillimit të negociatave për zgjidhjen e statusit, ashtu edhe për të qenë bartëse e zhvillimeve kryesore politike. Me këtë rast, kryeministri Çeku reagoi duke rikonfirmuar se ishte ai që e dirigjonte qeverinë dhe se nuk e njeh letrën e LDK-së si diçka serioze. Kështu si njëra, ashtu edhe tjetra parti e koalicionit qeveritar, u shkëputën nga çfarëdo qoftë realiteti: 'secila për vete në vete u bën simulakrum i pastër i vetes së tyre'.

E njëjta skemë mund të thuhet se vlen edhe për Shqipërinë. Pas rënies së komunizmit në zgjedhjet e para fitoi partia socialiste (ish PPSH). Kjo e paraqiste 'reflektimin e realitetit bazik'. Të dytat zgjedhje të parakohshme i fitoi PD, me ç'rast u 'fshih dhe u deformua realiteti bazik'. Skemat piramidale imponuan zgjedhje të parakohshme nga të cilat 'fajtorët' u ndëshkuan me votën e popullit, duke i sjellë rishtaz socialistët në pushtet, pra 'u ndërpre mungesa e realitetit bazik'. U caktua një qeveri transitore e unitetit me kryeministrin opozitar (socialist) Bashkim Fino.

Konfliktet brendapërbrenda socialistëve, ndarja e LSI-së (konkretisht Ilir Metës) nga trangu i PS-së, korrupsioni galopant dhe sundimi i kaosit në vend të ligjit, bën që zgjedhjet e fundit t'i fitojnë demokratët.

Megjithëkëtë opozita nuk shfaq simp-toma çtensionimi, kështu që edhe këtu kemi shkëputjen e dy subjekteve politike nga realiteti: secila për vete në vete janë bërë simulakrum i pastër në veten e tyre.

Tash në opozitë janë socialistët që janë më të zëshëm pas heqjes (së përkohshme të Nanos nga skena politike). Ata u treguan se dinë të bëhen edhe agresivë kur është nevoja, duke mos u skuqur fare që t'i qërojnë hesapet edhe fizikisht me pushtetarët, qoftë edhe kur kundërshtari është femër. Më 28 korrik 2006, ditë e premtje, në parlamentin shqiptar sulmohet fizikisht nga ish kryeministri socialist Ilir Meta, kryeparlamentarja

demokrate Jozefina Topalli.

Presidenti Alfred Moisiu është në pozicionin pat. Ai është kryetar koncensual dhe mundohet ta ruajë neutralitetin me çdo kusht (me gjasë shpreson të fitojë edhe ndonjë mandat). Nga ana tjetër PD dëshiron t'i bëjë disa veprime duke ndërhyrë edhe në KQZ, si duket për t'ia lehtësuar vetes marrjen edhe të pushtetit lokal, edhe vazhdimësinë e pushtetit parlamentar dhe qeverisës. Këto polarizime e dëmtojnë qartë imazhin e vendit në botë. Kjo nuk i konvenon PD, prandaj gjithnjë e më tepër shihet se dëshiron uljen e gjakrave.

Më 12 gusht 2006 mediat përcollën intervistën e kryeministrit Sali Berisha dhënë "Zërit të Amerikës" me titull 'Berisha fton përsëri opozitën për bashkëpunim për reformat e vendit'. Megjithëkëtë opozita nuk shfaq simp-toma çtensionimi, kështu që edhe këtu kemi shkëputjen e dy subjekteve politike nga realiteti: secila për vete në vete janë bërë simulakrum i pastër në veten e tyre.

Situata në Kosovë dhe në përgjithësi ku jetojnë shqiptarët të kujton një film amerikan me titull "Slacker" (dembeli, bishtnuesi, përtaci) që bën fjalë për humbjen dhe shkapërderdhjen e të rinjve amerikanë

Shqipëria dhe Kosova në këtë mënyrë janë shndërruar në një Dizniland të Bodrijarit, duke rënë në hiper-realitet. Njëra shpreson anëtarësimin e shpejtë në strukturat euroatlantike, kurse tjetra pavarësinë e saj; që të dyja i kanë hedhur sytë nga faktori ndërkombëtar. Dizniland është pjesa tjetër e Amerikës. Zhan Bodrijar theksonte se "Diznilendi është i vendosur si imagjinari, ashtu që ta përkrahë besimin se çdo gjë tjetër është reale, edhe pse Los Anxhelosi dhe Amerika, të cilat e rrethojnë, më nuk janë reale, por bëjnë pjesë në një lloj të mbireales dhe simulacionit. Nuk kemi të bëjmë më ndonjë përfytyrim të rrejshëm të realitetit (ideologjisë), kemi të bëjmë me të fshehurit, se realiteti më nuk është realitet, pra me shpëtimin e parimit të realitetit"

Ai nënkupton krijimin e diçkaje imagjinare, që duhet ta ushqejë besimin tonë në principin e reales, realitetit, përmes së cilës duhet të rikrijohet realiteti, të rivendoset ose të rigjenerohet ai. Realiteti është përhumbur dhe në vend të tij kanë mbetur shenjat dhe sistemet, simulakrumet disimulacionet e tyre. A është për

ne ngushëllues fakti se Dizniland sipas Bodrijarit, nuk është shtëpi fantastike e argëtimit dhe shkëput-ur nga Amerika e vërtetë, por është vetë themeli i mundësisë së shfaqjes në Amerikë si 'realitet në botën post-moderne'?!...

Jemi shpërndarë dhe jemi përçarë në mënyrë të hatashme. Shkapërderdhja jonë ka shumë specifika, por ajo ka të bëjë edhe me civilizimin postmodern perëndimor.

Të gjithë e dinë se Kosova është në skamje. 60 % e popullatës përballen me varfëri, 14% me varfëri ekstreme, por, nga ana tjetër, përditë shikon të ngrihen shtëpi e ndërtesa luksoze, kafenetë janë të mbushura me të rinj, rrugës mahnitësh me vetura luksoze... Realiteti i shpërfytyruar në Shqipëri dhe Kosovë është një hiper-realitet që duke synuar të jetë diçka ekstra ose super, kthehet në pseudo.

Situata në Kosovë dhe në përgjithësi ku jetojnë shqiptarët të kujton një film amerikan me titull "Slacker" (dembeli, bishtnuesi, përtaci) që bën fjalë për humbjen dhe shkapërderdhjen e të rinjve amerikanë. Në film gjithçka duket e çuditshme: ngjarja dhe protagonistët. Njëri zakonisht flet për tema politike, tjetri është i magjepsur pas Elvis Prislit, një femër e re përpigjet të shesë një brisk të Madonës për test gjinekologjik, tipi tjetër flet se si Bushi nuk i ka fituar zgjedhjet në mënyrë legjitime (më 1988), një zezak i ri shet fanella me mbishkrimin "lirojeni Mandelën!" dhe ekzekuton një rep politik të stereotipizuar, një artistaktivist në dhomë mban plot televizorë dhe videokasete, dy vetë në kafene filozofojnë për filmat vizatimorë...

Skena të përafërta janë edhe ato të përditshmërisë sonë. Jemi shpërndarë dhe jemi përçarë në mënyrë të hatashme. Shkapërderdhja jonë ka shumë specifika, por ajo ka të bëjë edhe me civilizimin postmodern perëndimor. Pak gjëra na lidhin. Aq jemi përimitësuar në kuantitet (parti, asociacione, media...) sa që pothuajse i kemi humbur të gjitha standardet për kualitet. Arsimi na është shndërruar në mikro dhe makro biznes, kultura gati është tretur dhe është avulluar në forma rituale e ceremoniale, sfera publike është bërë inerte dhe manipuluese. Ndjenjat etnike dhe religjioze janë bërë të pamjaf-tueshme dhe komplekse. Siç thotë Daniel Bell në librin "The cultural contradictions", "Ngjarjet, rruga, skena...tash janë parametra jo vetëm të artit, por edhe të jetës"

Tensioni në Universitetin e Prishtinës

NJOHURI TË PAKTA PËR PROCESIN E BOLONJËS

Universiteti i Prishtinës me të vërtetë është në një gjendje alarmuese, për vet faktin se shumica e profesorëve bashkë me studentët nuk kanë njohuri për “Deklaratën e Bolonjës”. Studentët duhet të dinë për të drejtat e tyre, se si të ankohen dhe të kenë argumente për ankesën e tyre.

Mergim LUSHTAKU



Universiteti i Prishtinës është në një gjendje alarmuese, për vetë faktin se shumica e profesorëve dhe studentëve nuk kanë njohuri për “Deklaratën e Bolonjës”. Studentët duhet të dinë për të drejtat e tyre, se si të ankohen dhe të kenë argumente për ankesën e tyre. Kjo gjendje vjen për shkak të jo-seriozitetit të profesorëve, e në veçanti të strukturës udhëheqëse të Fakulteteve. Profesorët përtojnë të ndjekin trajnime që kanë të bëjnë me reforma. Edhe ata që diçka kanë mësuar për procesin e Bolonjës, e kanë keqkuptuar pjesën më të madhe të këtij procesi. Ata as që janë konsultuar me koordinatorët e ECTS. Kemi raste të ndryshme në fakultete ku studentët kanë dëshiruar dhe kanë marrë iniciativë për t'u transferuar prej një departamenti, në një departament tjetër, brenda të njëjtit Fakultet. Fatkeqësisht struktura udhëheqëse e këtij Fakulteti e ka keqkuptuar Deklaratën e Bolonjës,

dhe kemi shumë raste kur procesin e Bolonjës e kanë kuptuar në mënyrë gjysmake. Ndodh që strukturat udhëheqëse e dinë se studentit i lejohet të ndjekë (të dëgjojë dhe të hyjë në provim) një lëndë, një semestër apo edhe një vit në një Fakultet, apo edhe në një vend tjetër, por e ndalojnë që ta ndërrojë departamentin në të njëjtin Fakultet. Dhe thonë: “Nëse do ta ndërrosh departamentin, atëherë fillo nga fillimi”. Por, realiteti është ndryshe: Deklarata e Bolonjës dhe ECTS-ja e lejon transferimin apo mobilitetin e studentit jo vetëm brenda Universitetit, por edhe jashtë tij, që do të thotë edhe në universitete të tjera në Evropë. Problem tjetër janë edhe afatet! Afatet sipas statutit të UP-së janë të përcaktuar në 3 (neni 124, pika 2), por në gjendjen reale të cilën UP-ja ka tani për tani, studentit e ka të vështirë të diplomojë në tri afate dhe me 14 provime në vit. Nëse dëshirojmë të praktikojmë reformat në UP, duhet bërë aplikimi i duhur, me vend dhe me kohë. E kjo mund të bëhet me reformimin e lëndëve dhe aplikimin e metodës së ECTS-së, e cila merr parasysh

edhe ngarkesën e studentëve gjatë studimit të një lënde. Ndryshime duhet të bëhen sa më parë. Ndryshime duhet të bëhen tek lëndët, vlerësimi sipas ngarkesës së studentit, informimi për procesin e Bolonjës, aplikimi i kredive në mënyrë të drejtë, etj. Punën me të madhe tani momentalisht e kanë strukturat e Fakulteteve, bashkë me studentët, që do të ndikojnë që të mos ketë padrejtësi. Nëse profesorët dhe studentët ia dëshirojnë të mirën Universitetit të Prishtinës dhe kualitetit të studimeve, atëherë duhet të fillojnë të jenë më aktivë rreth njohurive të Procesit të Bolonjës. Një fjalë e urtë thotë: “*Liria është si ajri; nuk hetohet derisa nuk fillon të zhduket*”, kështu që ne duhet t'i dimë të drejtat tona dhe mos të na bien ndërmend atëherë kur nuk kanë më rëndësi. Fundi i realizimit të procesit të Bolonjës është viti 2010. Prandaj, duhet të veprojmë sa më energjikisht që të përmbushen objektivat e këtij procesi, ashtu që Universiteti i Prishtinës të bëhet promotor i zhvillimit të vendit tonë.



Papunësia, kancer i shoqërisë

PROBLEM SOCIAL APO PROBLEM POLITIK?

13% e popullsisë apo 350 mijë persona, gjegjësisht 65 mijë familje janë në varfëri të skajshme, varfëri e cila i shtyn ata të bëjnë shitjen e pasurisë së tyre, si shtëpitë, tokat, stolitë e gruas, e më e keqja e të këqijave është se nga ky 13% i varfërisë ekstreme janë shitur edhe organet e trupit, si veshka, etj. Kjo shkon edhe më tutje, kur këta njerëz sillen rreth klinikave tona që të shesin gjakun e tyre, në mënyrë që të sigurojnë jetesën e tyre.

Arber ZEKA

Nga 2.5 milion banorë, që ka Kosova, 1.25 milion prej tyre jetojnë në varfëri si rezultat i papunësisë së madhe që mbretëron në vendin tonë.

Papunësia është faktori i cili ka bërë që 13% e popullsisë të jetojë në varfëri të skajshme. Kjo nënkupton njerëz të moshuar pa strehë, fëmijë të cilët kalojnë kohën nëpër plehra për të gjurmuar për kanaçe, apo për ndonjë metal që mund ta shesin. Kjo shkon edhe më tutje, kur ata gjurmojnë në plehra për ushqim.

Janë këto disa fakte të përditshmërisë së shoqërisë sonë në të cilën ne sot jetojmë. E gjithë kjo vjen si rezultat i moskrijimit të vendeve të reja të punës.

Siç e cekëm më lart, 13% e popullsisë

apo 350 mijë persona, gjegjësisht 65 mijë familje (studim i Bankës Botërore) janë në varfëri të skajshme, varfëri e cila i shtyn ata të bëjnë publikimin e shitjes së pasurisë së tyre, si shtëpitë, tokat, stolitë e gruas, e më e keqja e të këqijave është se, nga ky 13% i varfërisë ekstreme janë shitur edhe organet e trupit, si veshka, etj. Kjo shkon edhe më tutje, kur këta njerëz sillen rreth klinikave tona që të shesin gjakun e tyre, në mënyrë që të sigurojnë jetesën e tyre.

Sipas hulumtimeve të bëra nga UNDP-ja dhe Riinvesti gjatë vitit 2005, konstatohet se: 49% mendojnë se janë probleme sociale, kurse 33% mendojnë se janë probleme politike. Por, megjithatë, këto

të dyja janë elemente që bashkohen për derisa politika është ajo që udhëheq shoqërinë.

Problemet në shoqërinë tonë sa vijnë e shtohen. Nga një anketë e zhvilluar me qytetarët, nxirret se 55% e të intervistuarve, në lidhje me problemet e Kosovës, mendon se problemi kryesor i ngecjes së zhvillimit të vendit tonë është rezultat i papunësisë. Papunësia sa vjen e shtohet dhe në bazë të statistikave momentale, 60% e popullsisë së Kosovës është e papunë.

Pse s'ka punë?

Kosova është një vend ku investohet shumë pak para për industritë të cilat do të



mund të hapnin vende të reja pune. Sektori i bujqësisë, i cili është një prej sektorëve më të rëndësishëm për zhvillimin e një shteti, është gati i pashfrytëzuar. Kosova me bujqësinë e saj do të mund t'i mbulonte vetë të gjitha nevojat për ushqim. Prandaj të mirat që Zoti u ka dhuruar kosovarëve, si edhe të mirën që bukën ta sigurojnë nga vet vendi i tyre, ata i lënë të pashfrytëzuara. Kosova posedon sa e sa hektarë tokë që do të mund t'i mbillte me grurë dhe nga ky grurë do të mund të siguronte miell për qytetarë e vet.

Me tokën që disponon Kosova, jo vetëm që do të mund të arrinte t'i përmbushte nevojat e veta, por do të mund të furnizonte edhe disa shtete përreth. Me këtë do të krijoheshin vende të reja pune, që do ta zbusnin sadopak papunësinë e madhe që mbretëron.

Një shqetësim tjetër për vendet e punës dhe të mirat e tyre materiale është pakësimi i misionit të OKB së, që ka shpenzuar 2.6 miliardë euro në Kosovë. Ky burim i të ardhurave për kosovarët do të jetë një goditje e madhe gjatë vitit 2007, duke u bazuar në atë se pjesëtarët e saj do të pakësohen vazhdimisht, kur gjithashtu e dimë se edhe një pjesë e madhe e kosovarëve janë të punësuar në këtë mision. Ku do të punojnë ata kur këtij misioni t'i vijë fundi?

Kosova, një Vend i Harruar apo Punë e Korruptuar?

Kosova po jeton në vendin e harruar, ku çdo ditë e më shumë po përballet me mungesën e vendeve të punës. Ekonomia e paqëndrueshme dhe mungesa e rritjes së investimeve në Kosovë është kërcënim për të ardhmen e saj. Në mënyrë të veçantë, mund të themi se papunësia është kërcënimi kryesor. A mund të ketë diçka më të dëmshme për papunësinë se sa prezencja e korrupsionit në vendin tonë?

Kur miqtë dhe pjesëtarët e të njëjtës familje janë nëpër poste zyrtare, gjendje e cila është shumë prezente në Kosovë, a është diçka tjetër përveçse KORRUPSION? A thua çfarë është, për ata të cilët se kuptojnë apo nuk duan ta kuptojnë, termi i shumë përfolur korrupsion?

Korrupsioni lidhet me atë kur dikush e shpërdoron pushtetin, apo vendin e punës që i është besuar, për të pasur përfitime personale. Në këtë rast ky njeri, apo keqpërdorimet e bëra nga ana e tij, e bëjnë atë që të jetë njeri i korruptuar. Të tillë janë ata që me pozitat e tyre nuk bëjnë asgjë tjetër përveç rritjes së pagave

të tyre dhe pranimit të stafit të ri punues, vetëm nëpërmjet marrjes së mitos. A thua ku e dërgojnë këtë shoqëri, prej dy milion e gjysmë banorë, këta njerëz? Çfarë po bëjmë ne si pjesë e kësaj shoqërie që kjo gjendje të ndryshojë? Apo ndoshta jemi të kënaqur me këtë gjendje? Nuk duhet të presim që të huajt të vijnë të na i zgjidhin problemet tona, sepse edhe ne kemi potenciale hiç më pak se ata, dhe punët tona mund t'i zgjedhim edhe vetë. Ajo çfarë i duhet më tepër kësaj shoqërie është dashuria ndaj njëri tjetrit.

Qeveria e Kosovës sikurse s'ka plane konkrete për hapjen e vendeve të reja të punës, dhe as që ka ndonjë plan në këtë drejtim.

Pra mund të përfundojmë se, në qoftë se buxheti i Kosovës do të administrohej në rregull duke anuar kah drejtësia, sigurisht se pushtetarët do të kishin kohë të merreshin me projekte, që do të reflektonin në hapjen e vendeve të reja të punës.

Nëse çdo punë që çon në dëm të të tjerëve, dhe i siguron vetes dobi të tepërta, paga të

korruptuara, dhe korrupsioni bëhet një problem dhe një sfidë shumë e madhe për shoqërinë tonë.

Si do të sigurojmë një të ardhme me punë?

Me gjithë rrethanat aktuale, Kosova në fakt mund të mbijetojë. Por për ta përballuar sprovën duhen ndryshime rrënjësore. Kosova është ende e izoluar dhe asaj i duhet ta zgjidhë sa më shpejt statusin e saj të padefinuar. Qeveria duhet të bëjë investime thelbësore në arsim, pasi Kosova momentalisht ka normën më të ulët në Evropë për ndjekjen e shkollës, pas asaj të ciklit të dytë. Gjithashtu, qeveria e Kosovës duhet të ketë një qasje krejt ndryshe ndaj korrupsionit. Populli i Kosovës duhet ta kuptojë së pavarësia nuk është shkop magjik, për t'i zgjidhur të gjitha problemet.

Rinia duhet ta ndryshojë mendimin e saj për Perëndimin, pasi Perëndimi nuk është vendi ku njeriu mbledh para me grabujë dhe e mbush thesin me para. I riu duhet të



majme, bile edhe shtëpi me pishinë dhe privilegje të tjera në pushtet, atëherë themi se:

Janë të paparashikuara pasojat që sjell korrupsioni dhe marrëdhëniet e

ketë një qasje tjetër ndaj kësaj pikë-pamjeje, dhe ai duhet ta kuptojë se kudo që të punojë, edhe do të fitojë, prandaj duhet të punojë në vendin e vet dhe të fitojë në vendin e vet.

Kushtet e studentëve në konvikte

80% E TË ANKETUARVE NUK JANË TË KËNAQUR ME KUSHTET NË KONVIKTE

Me këtë hulumtim kemi konstatuar se 31% e të anketuarve banojnë në konvikte për shkak të kushteve ekonomike, ku 34% e tyre mendojnë se pagesa prej 40 euro në muaj është e lartë, 60 % mendojnë se pagesa është mesatarisht e ulët, kurse 6% mendojnë se kjo pagesë është e ulët.

Driton BUBLAKU & Zymber OSMANI

Studentët të cilët banojnë në kompleksin e konvikteve që gjendet në lagjen Ulpiana të kryeqytetit, ballafaqohen me probleme nga më të ndryshme. Ndër problemet kryesore të tyre janë: uji i ngrohtë, ngrohja dhe ushqimi.

Në një hulumtim empirik të bërë nga një grup studentësh të Departamentit të Gazetarisë, që vepron në kuadër të Fakultetit Filozofik, studentët, banues të këtyre konvikteve, kanë shfaqur problemet me të cilat ata kryesisht përballen. Nga ky hulumtim, i kryer me 100 studentë, dalin statistika të cilat në të ardhmen duhet të prekin së paku ndërgjegjen e administratës së konvikteve, që këta të fundit të jenë më të kujdesshëm në menaxhimin e fondeve që studentët paguajnë gjatë një muaji.

Sipas këtij anketimi të realizuar brenda pesë ditëve del se studentët që banojnë në konvikte, problem të veçantë kanë ujin e ngrohtë, ku 87% e të anketuarve e vlerësojnë këtë si problem bazë, ndërsa 27 % kanë probleme me ngrohjen.

Me këtë hulumtim kemi konstatuar se 31% e të anketuarve banojnë në konvikte për shkak të kushteve ekonomike, ku 34% e tyre mendojnë se

pagesa prej 40 euro në muaj është e lartë, 60 % mendojnë se pagesa është mesatarisht e ulët, kurse 6% mendojnë se kjo pagesë është e ulët.

Në qendrën e studentëve janë pranuar me konkurs të rregullt 88% e të anketuarve, ndërsa 12% me ndërmjetësi.

29% e të anketuarve mendojnë se në konvikte ka shumë ilegalitet, 11% mendojnë mesatarisht, 24% mendojnë se ka pak, 1% mendojnë se nuk ka fare, ndërsa 34% nuk dinë për këtë problem. 74% e të anketuarve janë të kënaqur mesatarisht me kushtet në konvikte, 22% pak të kënaqur, ndërsa 2 % aspak të kënaqur .

Studentët jo vetëm që kanë probleme me kushtet e tyre të banimit, por edhe me administratën e konvikteve. 21% e të anketuarve nuk e dinë se kush i administron, 8% nuk e vlerësojnë aspak punën e tyre, 18% e vlerësojnë pak, 32% mesatarisht, ndërsa 16% e të anketuarve e vlerësojnë shu

më të mirë punën e administratës.

Rregullorja për mbylljen e derës në konvikte në orën 23:00, vlen vetëm për 89% të të anketuarve, por jo edhe për 11% që nuk e respektojnë atë. Kjo rregullore i pengon në aktivitetin studimor 21% të anketuarve, por jo edhe pjesës tjetër .

Se sa respektohet hyrje dalja e meshkujve në konviktin e femrave dhe anasjelltas, 23% e të anketuarve shprehen se kjo nuk respektohet dhe se atyre iu pengon, 35 % mendojnë se respektohet mesatarisht, ndërsa 42% e të anketuarve shprehen se kjo nuk ju pengon fare.

Pjesën më të madhe të mësimin, për shkak të kushteve, 51% e të anketuarve e mësojnë në konvikte, 45% në Bibliotekën Kombëtare dhe 18% në bibliotekat e tjera të qytetit .

Në mensën e konvikteve ushqehen 59% e të anketuarve , 17% e përgatisin ushqimin vetë dhe 17% ushqehen në qytet. Prej

atyre të cilët ushqehen në mensë, vetëm 31% e konsiderojnë ushqimin e mirë, 34% mendojnë se ushqimi është mesatarisht i mirë, ndërsa 24% e vlerësojnë pak ushqimin.

Në përfundim të këtij hulumtimi del se 80% e të anketuarve nuk janë të kënaqur me kushtet në konvikte dhe do të donin t'i ndërrojnë ato, 14% mendojnë më shumë për sigurinë, ndërsa 12% dëshirojnë të ketë ndryshim në pamjen e konvikteve. 49% e të anketuarve do të donin ta ndërrojnë konviktin me banesë private, ndërsa 51 shprehën dëshirën të jetojnë edhe më tutje në konvikte .

Në këtë hulumtim janë anketuar 100 studentë të të dy gjinive, mosha mesatare e të cilëve arrin 21.56 vjet.



Paralele kohësh

“TY PARTI T'JAP ME KUPTU”

Mjerë ai që s'ka parti! Kur je me parti, njerëzit të vijnë vërdallë e nuk të lënë rehat, ndërsa kur nuk je në parti, as nuk të përshëndesin. Kur je në parti, sillesh si intelektual e zotëri, e kur je pa parti, nuk të bën kush hesap se je njeri. Kështu e ka kjo punë partia është bërë gjithçka. Për dikë bile edhe Zot.

Zekerija IBRAHIMI

Ky titull është në fakt përkujtim në një poezi të kohës së komunizmit, të cilën shpesh e dëgjoja kur isha fëmijë, por kuptimin e saj e kam marrë vesh shumë vonë, atëherë kur e kuptova se dikur kur unë ende nuk kam qenë në këtë dynja, kur në këto hapësira ishte bërë kolektivizimi i pronës, njerëzit me këngë ia kishin dorëzuar pronën shtetit. Pikërisht kjo poezi më kujtohet sa herë që jam i detyruar të mendoj për jetën politike demokratike të vendit tonë. Tashmë është bërë më shumë se një dekadë e gjysmë qëkur te ne sistemi njëpartiak është zëvendësuar me atë shumëpartiak, por kur ia bën një barazim gjithë kësaj jete politike, njeriu dëshpërohet sa pak ndryshojnë këto dy kohë. Edhe pse çmimi i këtij ndërrimi ka qenë shumë i madh: shumë luftëra, gjak, vrasje e dërgjje. Por, kot.

Partia si fabrikë

Ja për shembull: edhe sot drejtorin e foshnjores e cakton partia, edhe edukatorin e çerdhes e cakton partia, edhe mësuesin e profesorin e cakton partia, edhe drejtorët e shkollave i cakton partia, edhe pastruesit e rojtarët e shkollës i cakton partia, edhe universitetet i krijon e i shkatërron partia, dekanët i cakton partia, i shkarkon partia dhe prapë i ngarkon partia. Po ashtu edhe rektorin e prorektorët i cakton partia, si edhe kryetarët e senatëve e të salltanetëve të tjera. Mjekë krijon partia, pra edhe shëndet partia. Partia i cakton, i punëson dhe i ç'punëson edhe administratorët, partia krijon dhe punëson përkthyes, partia prodhon doktorë shkencash që pastaj shkruajnë për historikun e partisë, partia prodhon shkencëtarë, në parti vendoset kush është marrë mjaft me politikë që tash e tutje ta vazhdojë zanatin e shkencëtarit, partia prodhon intelektualë e drejtorë ndërmar-rjesh. Partia prodhon çobanë, shoferë, hakerë, gangsterë, partia si fabrikë hesapi.

Partia për dikë edhe Zot

Je në parti, mund të jesh gjithkund, s'je në parti, s'je askund. Nuk është me rëndësi sa di, me rëndësi është a je në parti. Nuk është me rëndësi a e ke lexuar Platonin, me rëndësi është ta njohësh kryetarin, nënkryetarin a deputetin e partisë, fundja edhe ndonjë kryetar dege. Vetëm të jetë i partisë. Nuk është me rëndësi të jesh gazetar i mirë që të bëhesh redaktor e kryeredaktor, me rëndësi është ta dëgjosh shefin politik. Dëshiron të bëhesh polic, duhet të kesh lidhje në parti. Dëshiron të bësh biznes privat, duhet ta ndash me partinë. Dëshiron të bësh kontrabandë, duhet ta ndash me bosin e partisë. Me partinë gjithçka mundet, ndërsa pa partinë nuk mundet asgjë. Me parti bëhesh reis, kryetar i myslimanëve dhe myfti, ndërsa pa parti jep dorëheqje dhe bëhesh kolumnist i mirë ose, në shembullin më të skajshëm, heretik.

Me parti bëhesh hoxhë në xhami, drejtor në postë, shef në aeroport, rojtar në spital, pastrues në “Komunalec”, profesor në fakultet, kryetar i lidhjes së studentëve, student i gjeneratës, futbollist i vitit, sportist i vitit e ekip kampioni. Vashëzat me parti bëhen mise e prej aty sekretaresha nëpër zyrat e atyre të partisë, ndërsa djemtë me parti bëhen “mister”. Me parti bën kulturë, organizon festivale, merr çmime të para e të dyta, organizon ekspozita e pret shirita të kuq. Me parti je i respektuar, nuk e heq fare kravatën, ndërsa pa parti, strukesh nëpër qoshe dhe askush nuk të përfill. Me parti të ftoj në emisione, të debatosh, të japësh mendime, të propozosh (të llotosisësh kot), madje edhe vetëm të pozosh, ndërsa pa parti nuk të njeh njeri. Mjerë ai që s'ka parti! Kur je me parti, njerëzit të vijnë vërdallë e nuk të lënë rehat, ndërsa kur nuk je në parti, as nuk të përshëndesin. Kur je në parti, sillesh si intelektual e zotëri, e kur je pa parti, nuk të bën kush hesap se je njeri. Kush merr guxim të flasë kundër partisë, anatemohehet, përjashtohet nga puna dhe nga shoqëria,

bile jo vetëm ai, por gjithë familja e tij. Kështu e ka kjo punë partia është bërë gjithçka. Për dikë bile edhe Zot. Më shumë e do dhe i frikohet partisë se Zotit.

Partia më jep shtëpi

Kur më kujtohen të gjitha këto dhe shumë gjëra të tjera që nuk mund t'i shkruaj në këtë tekst, por që secili nga ju mund t'i shtojë së paku edhe nga dy-tre që bëhen me parti e që nuk bëhen pa parti, bindem se vërtet pa të drejtë njerëzit e shajnë me aq afsh sistemin e kaluar politik. Më vjen inat pse njerëzit janë aq të ndytë. Janë kundër asaj që vetë e veprojnë. Po më thoni a nuk kanë qenë të gjitha këto edhe në sistemin e kaluar? Madje në disa gjëra ne tash ia kalojmë atij sistemi. Kam përshtypjen se dallimi i vetëm mes atij dhe këtij sistemi është vetëm natyra e këtij teksti dhe emrat me të cilat emërtohen sendet. Tash herë punëson LSDM-ja, herë VMRO-ja, herë BDI-ja, herë PDSH-ja, por gjithnjë PARTIA. Në sistemin e kaluar së paku kjo ka qenë më lehtë, ke hyrë vetëm në një parti dhe aty më i ke rregulluar të gjitha punët. Tash njerëzit po detyrohen që për këto arsye të shëtisin nëpër të gjitha partitë e askund të mos zënë vend. Derisa t'ia arrijnë qëllimit: të bëhen të pasur, të bëhen shkencëtarë ose të marrin pozitë grandioze. Kameleon hesapi.

Prandaj ajo poezia “Ty parti t'jap me kuptu / se tokën në kooperativë e kam dorëzuar / tash edhe në katundin tonë / kooperativa si lule lulon. / O moj parti ti më je shtëpi / i gjithë katundi jeton në vëllazëri”, shkon aq bukur nëse ia ndërrojmë edhe vetëm disa fjalë për shkak të ndërrimit të viteve më shumë si numra sesa si përmbajtje. Për shembull: “Ty parti t'jap me kuptu / se nderin e jetën te ti i kam dorëzuar / tash edhe në mëhallën tonë / bukuria e degës tënde si lule lulon. / O moj parti ti më je shtëpi / i gjithë populli jeton në apati.”. Sa të ngjashme e të bukura, apo?

Epo, të na rrojë partia atëherë!

Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

NË PRITJE TË DOKUMENTIT TË AHTISAARIT

"Të gjithë ne, amerikanët dhe evropianët, mendojmë se Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara duhet të jenë sa më unikë" për çështjen e Kosovës, ka deklaruar shefi i diplomacisë evropiane Javier Solana i cili ka biseduar për Kosovën me Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki Moon.

Demir RESHITI

Gjysma e dytë e muajit dhjetor të vitit të kaluar dhe dhjetëditëshi i parë i këtij viti, është karakterizuar me disa takime që kryendërmjetësi i OKB-së për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari ka pasur me personalitete të rëndësishme të qendrave të vendosjes me qëllim të "harmoni-



Martti Ahtisaari

zimit" të qëndrimeve për rumbullakimin e propozimit të tij për statusin, i cili është paralajmëruar të bëhet publik menjëherë pas zgjedhjeve parlamentare në Serbi që do të mbahen më 21 janar.

Se çfarë do të përmbaj ky "propozim", janë duke u bërë prognoza nga më të ndryshmet, por emëruet i përbashkët i të gjitha këtyre prognozave është një pavarësi e kushtëzuar me mbikëqyrje ndërkombëtare nëpërmjet një misioni të ri i cili do ta zëvendësojë UNMIK-un, por kësaj radhe do të përbëhet nga Bashkimi Evropian.

E veçanta tjetër e zhvillimeve ndërkombëtare për Kosovën gjatë kësaj periudhe, është paralajmërimi për një raund të ri negociatash ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit i cili do të zhvillohet pas propozimit të Ahtisaarit.

Në vazhdim po e paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me statusin e Kosovës, në periudhën 20 dhjetor 2006 - 11 janar 2007.

(20 dhjetor) GNK-ja publikon raportin më të ri për Kosovën

Bruksel - Bashkësia Ndërkombëtare duhet t'i japë mbështetje të fuqishme dhe të pa rezervë të dërguarit të posaçëm të OKB-së për statusin e Kosovës, Martti

Ahtisaarit që të përfundojë procesin e zgjidhjes së statusit në pjesën e parë të vitit të ardhshëm, ka konstatuar GNK-ja, në raportin e saj të titulluar "Statusi i Kosovës, muajt e vështirë që na presin". Në kumtesën e publikuar në faqen e internetit të kësaj organizate, është theksuar se ekziston një shqetësim serioz se shtyrja e prezantimit të propozimit të Martti Ahtisaarit pas zgjedhjeve në Serbi, nuk do të jetë e fundit.

Bruksel - Europarlamentari holandez, Jost Lagendijk, ka përgatitur një raport për të ardhmen e Kosovës dhe rolin e BE-së. Raportuesi i Parlamentit Evropian Lagendijk, raporti i të cilit në fillim të vitit të ardhshëm do të shndërrohet në rezolutë, është shprehur i bindur se Bashkimi Evropian së shpejti do të ketë



Jost Lagendijk

punë me Kosovën, së cilës, sipas tij, bashkësia ndërkombëtare do t'i japë "një sovranitet të kufizuar"...

Berlin - Fillimi i vitit të ardhshëm do të jetë i mbushur me Kosovën dhe Serbinë, nëse në arenën ndërkombëtare nuk ndodh diçka më akute, ka vlerësuar ministri i jashtëm gjerman Valter Shtajnmajer. Ai ka thënë se pas zgjedhjeve në Serbi dhe publikimit të propozimit të Ahtisaarit për të ardhmen e Kosovës, BE ja duhet të tregojë unanimitet.

(21 dhjetor)

Uashington - Secili rajon është një rast në vete dhe ato do të zgjidhen në bazë të rrethanave të veçanta historike e shoqërore, andaj ne nuk e shohim një

ndërlidhje me rastin e Kosovës. Këtë e ka deklaruar zëdhënësi i Departamentit amerikan të Shtetit, Sean McCormack gjatë takimit të rregullt me gazetarë.

Bruksel - Do të duhet më shumë kohë se sa që është planifikuar për ta definuar statusin e Kosovës, ka deklaruar në Bruksel ish-kryeadministratori i Kosovës, Bernard Kouchner, me ç'rast i ka bërë ftesë Bashkimit Evropian për një rol më të gjerë në Kosovë.

"Mendoj se nuk ka zgjidhje tjetër, dhe ne do ta arrijmë atë, një status në mes të autonomisë së gjerë dhe pavarësisë së kontrolluar me trupa", ka thënë Kouchner.

(22 dhjetor) Chandler: Kosova do ta fitojë pavarësinë e kushtëzuar

Londër - Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin "Westminster" të Londrës, David Chandler, ka vlerësuar se Kosova do ta fitojë pavarësinë e kushtëzuar, por se raportet brenda faktorit ndërkombëtar do ta pengojnë pavarësimin real të saj. Chandler ka shprehur mendimin se Kosova do të ketë fat të ngjashëm me Bosnjë e Hercegovinën. Profesori Chandler një model të tillë të statusit të ardhshëm të Kosovës e ka quajtur pavarësi artificiale.



Sean McCormack

(25 dhjetor)

Uashington - "...Rezoluta e re e Këshillit të Sigurimit, do të specifikojë se çfarë pushteti do të ketë misioni i ri, i cili pritet

të sjellë në Kosovë nga 1000 deri në 1300 persona, nga të cilët 900 deri në 1000 do të jenë oficerë policie...”, ka deklaruar në një bisedë për “Zërin e Amerikës” shefi i pjesës së misionit të ri planifikues të BE-së që do të merret me drejtësinë dhe policinë, Casper Klunge.



Aleksandar Aleksejev

(26 dhjetor) Aleksejev: Rusia nuk do ta ndryshojë qëndrimin për Kosovën
Beograd - “Rusia nuk do ta ndryshojë qëndrimin për zgjidhjen kompromise për statusin e Kosovës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe e pranueshme për Beogradin dhe Prishtinën”, ka thënë ambasadori rus në Serbi, Aleksandar Aleksejev, gjatë një ligjërate të mbajtur para studentëve të Fakultetit Juridik në Kragujevc.

(27 dhjetor)

Paris - Rusia po e shfrytëzon krizën në Kosovë për të konsoliduar kthimin e vet në skenën ndërkombëtare, ka vlerësuar e përditshmja parisienne “Le Figaro”. “Prej ardhjes së Putinit në pushtet, Moska çartë dhe zëshëm thekson rolin e vet të fuqisë së madhe. Çështja e Kosovës është në mënyrë të drejtpërdrejtë e lidhur edhe me Gruzinë, siç është Irani për SHBA-në: prioriteti i politikës së jashtme”, ka konstatuar “Le Figaro”.

(8 janar) Merkel: “Nuk do të jetë më pak pavarësi”

Berlin - Në një intervistë dhënë kanalit të dytë “ZDF”, kancelarja gjermane Angela Merkel e cila është edhe kryetarja e radhës e BE-së, nuk ka pranuar të prononcohet për statusin e ardhshëm të Kosovës, pa dëgjuar një herë propozimin Ahtisaarit. “Nuk do të jetë më pak pavarësi”, ka thënë Merkel.

(9 janar) Ahtisaari më 26 janar do ta

paraqes propozimin...

Nju Jork - I dërguari i posaçëm i OKB-së për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari, do t'i njoftojë në një takim në Vjenë, më 26 janar, me dokumentin e tij mbi statusin final të Kosovës, përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ata të vendeve evropiane dhe Rusinë, ka paralajmëruar e përditshmja e Nju Jorkut “The New York Times”. Kjo gazetë ka cituar burime të paemëruara diplomatike që kanë thënë se Këshilli i Sigurimit më pas do të votojë për rekomandimin e Ahtisaarit, i cili pritet të jetë i tillë që i hap dyert pavarësisë së Kosovës, që për një periudhë do të jetë e mbikëqyruar nga Bashkimi Evropian.

Nju Jork - “Të gjithë ne, amerikanët dhe evropianët, mendojmë se Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara duhet të jenë sa më unikë” për çështjen e Kosovës, ka deklaruar shefi i diplomacisë evropiane Javier Solana i cili ka biseduar për Kosovën me Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki Moon. Solana ka thënë se nuk



Angela Merkel

beson se do të përdoret vetoja nga askush, pasi që vetoja nuk do të ndihmonte aspak në gjetjen e zgjidhjes për statusin e Kosovës.

Madrid - Ministri i Jashtëm i Spanjës, Miguel Angel Moratinos i cili është edhe kryesues aktual i OSBE-së, ka deklaruar se OSBE-ja do të vazhdojë të qëndrojë në Kosovë edhe pas miratimit të statusit përfundimtar. Këto komente ai i ka bërë në Madrid pas takimit me të dërguarin e posaçëm të OKB-së për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari.

(10 janar) Appathurai: NATO do të mbështesë qëndrimin e Ahtisaarit

Bruksel - I dërguari i posaçëm i OKB-së për statusin, Martti Ahtisaari, në një bisedë telefonike me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jap De Hop Schefer, ka konfirmuar se do të veprohet shpejt në çështjen e statusit të Kosovës. Zëdhënësi i NATO-s, James Appathurai, duke shpjeguar detajet e kësaj bisede, ka thënë se Ahtisaari i di pozicionet e

NATO-s për çështje që kanë lidhje me NATO-n dhe kjo e fundit do të mbështesë qëndrimin e presidentit Ahtisaari.

Nju Jork - Qëndrimi i ndërmjetësuesit Martti Ahtisaari do t'iu bëhet i njohur të dyja palëve më së voni deri në fillim të shkurtit, ka thënë në Nju Jork, udhëheqësi i Politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian, Javier Solana. “Kosova do të jetë në zemër të debateve këtu, në Kombet e Bashkuara”, ka theksuar Solana, duke shtuar se ky debat pritet pas zgjedhjeve serbe më 21 janar.

(11 janar) GNK: Edhe dy javë negociata shtesë pas propozimit të Ahtisaarit

Bruksel - Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të propozojnë edhe dy javë negociata shtesë pasi i dërguari i posaçëm i OKB-së Martti Ahtisaari ta paraqesë propozimin e tij për statusin e Kosovës, ka deklaruar të enjten në Bruksel, drejtori i Grupit Ndërkombëtar të Krizave (GNK) për Kosovë Alex Anderson, duke u thirrur në burime brenda administratës amerikane.

Londër - Zyrtarë ndërkombëtarë i kanë thënë BBC-së se i dërguari i posaçëm i OKB-së për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari, pritet ta paraqesë raportin e tij në Prishtinë dhe Beograd më 2 shkurt. Diplomata të huaj kanë deklaruar se raporti fillimisht do të diskutohet me anëtarët e Grupit të Kontaktit para se Ahtisaari t'ua paraqesë atë vetë palës shqiptare dhe asaj serbe.

Londër - “Shpresoj se Ahtisaari do të bëjë një propozim të mirë, të balancuar dhe të



Javier Solana

pranueshëm nga të dyja palët, ndonëse nuk mund të garantojë këtë”, ka deklaruar zëdhënësi i UNOSEK-ut Remi Dourlot në një intervistë për radion BBC.

Paradokse

MARRËVESHJE ABSURDE E PARISË ISLAME

Festat e Bajramit nuk janë festa shtetërore, as kombëtare. Nuk janë as të Arabisë, as të Shqipërisë. (La sharkijja ve la garbijje) Nuk janë as përvjetor i subjekteve politikë, që shtetet apo kombet ta caktojnë ditën se kur duhet të festohen. Këto janë festa fetare islame të përcaktuara me mbështetje në Kuran dhe të praktikuara sipas traditës islame që mbështet në praktikën e Pejgamberit Muhammed a.s. duke filluar pas vitit 622, dhe vazhdojnë deri sot.

Na ndodhi edhe kjo (një këngë moderne)

Feti MEHDIU



Po sigurisht ndodh! Mund të na ndodhi edhe më zi!

Kështu ndodh nëse nuk mendohet si do të dilet përpara se të futesh në një rrugë të cilën nuk e ke kaluar ndonjëherë më

parë, nga arsyeja se secili dëshiron të bëhet bajraktar. Secili mendon se duhet t'i dijë të tëra punët, madje më tepër, edhe ato që nuk janë të tij, e të vetat nuk kryen fare.

Kështu veprojnë disa institucione islame sot. Pas deklarimit të këtyre institucioneve paraqiten edhe zëra sarkastik, të cilët mbase mendojnë edhe seriozisht se secili shtet ku jetojnë muslimanë duhet të ketë teleskopë për të përcjellë lëvizjen e trupave qiellorë.

Këtë mundësi, atyre që janë të disponuar për t'u tallur me festat islame, po ua japin institucionet islame, të cilat si duket kanë lidhur marrëveshje që asnjëherë të mos merren vesh, as për festat e përbashkëta: Fitër Bajramin dhe Kurban Bajramin vetëm dy festa gjatë tërë vitit, që festohen prej shekullit të shtatë, nga i tërë opinioni islam në mbarë botën.

Kjo u dëshmuar edhe në rastin e Kurban Bajramit të vitit 1427. h. (2006.)

Edhe sot ka zëra nga individë, apo edhe institucione me kompetencë, që shprehen me papërgjegjësi për çështje shumë serioze, siç është festa e Kurban Bajramit, sipas të cilëve ka hapësirë që këto festa t'i caktojnë shtetet: "...në bazë të mendimeve të dijetarëve..."

A ka dijetar që mund t'ia caktojë hënës rrugën?!

Ka dijetarë që mund ta përcjellin rrugën e hënës dhe ata e kanë obligim që të informojnë botën se kur bëhet hëna e re, e në asnjë mënyrë nuk besoj se ka dijetar që ia cakton rrugën hënës për tërë vitin.

Për këtë le ta japin mendimin ekspertët e kësaj fushe.

Festat e Bajramit nuk janë festa shtetërore, as kombëtare. Nuk janë as të Arabisë, as të Shqipërisë. (...La sharkijja ve la garbijje...) Nuk janë as përvjetor i subjekteve politikë, që shtetet apo kombet ta caktojnë ditën se kur duhet të festohen. Këto janë festa fetare islame të përcaktuara me mbështetje në Kur'an dhe të praktikuara sipas traditës islame që mbështet në praktikën e Pejgamberit Muhammed a.s. duke filluar pas vitit 622, dhe vazhdojnë deri sot. Por ama të gjithë popujt e botës, të cilët kanë pëlqyer për fe të tyre fenë islame janë të interesuar, dhe kanë të drejtë dhe obligim që të kërkojnë nga paria e tyre të sillen më me përgjegjësi fetare dhe larg ngjyrimeve ideologjike sa i përket festimit të këtyre ditëve të shënuara.

Tendenca për të marrë primat dhe për të diktuar i ngjan peripecive që përjetoi Krishterimi në dhjetë shekujt e parë, derisa arriti që së pari të zhvendoset nga trualli ku u lind Jezu Krishti, (h. Isa a.s.) dhe pastaj të themelojë dy qendra rivale të Krishterimit që të dyja jashtë truallit ku kishte vepruar Ungjilli i h. Isait a.s.: Kishën e Stambollit-Kostandinopojës dhe Kishën e Romës.

Sa shërbim të keq i afron paria islame fesë dhe njerëzimit në përgjithësi!

Po sa keq që edhe shqip-

tarët i bëjnë shërbim kësaj tendence!

Për fat të keq, edhe sot, në shekullin 21 dikush mendon të silltet si në shekullin 19 apo në fillim të shekullit të 20-të, kur hapësira shqiptare nuk e dinte çka është radioja, e lëre më televizioni. Komunikimi elektronik as që mund të imagjinohej.

Kanë kaluar dhe janë harruar kohët kur në një fshat, madje edhe tek më i madhi, kishte vetëm dy radio aparate. Kanë mbet larg vitet e shtatëdhjeta të shekullit njëzet kur kishte vetëm dy herë në javë program



televiziv, e aparate televizive kishin aq veta sa mund t'i numëroje në gishtat e vetëm njërës dorë. Kanë kaluar ato kohë kur disa imamë ishin të ngarkuar që me disa mjete të thjeshta të përcjellin rrugën e hënës dhe të mbajnë rendin e fillimit të Ramazanit apo fillimit të festave të Bajramit.

Fakti se hëna nuk shihet në të gjitha vendet e botës në të njëjtën kohë, nuk e arsyeton aspak vonesën e festës Islame Bajramit as për një ditë e lëre më për dy ditë. Ky fakt sot u shërben vetëm atyre që dëshirojnë të manipulojnë dhe të fusin hutim në masën e painformuar. Këtë fakt e dinë edhe nxënësit e shkollës. E dinë të gjithë se agimi e ngrysja në Stamboll ndodhin përpara se të ndodhë në Sevilje, e në Prishtinë ndodhin përpara se të ndodhin në Paris, por të rriturit ekspertët duhet të japin përgjigjen se në asnjë vend të botës normale (jo në pole të veriut e të jugut) ai dallim nuk kalon më shumë se 10 a 11 orë, kurse një ditë e kalendarit zgjat 24 orë.

Prandaj nuk mund të dështojë një ditë e tërë për shkak të dallimit prej disa orësh. Mandej duhet pasur e qartë se kur bëhet hëna e re, në cilindo kënd të botës qoftë, ajo nuk kthehet më në gjendjen e fazës së katërt paraprake, por do të vazhdojë që edhe në atë vendin tjetër, ku konfiguracioni i kësaj toke e kërkon që të shihet një, a më shumë orë më vonë në rrugën e vet të rrotullimit do të paraqitet hënë e re, që do të thotë se ka filluar ditë e re.

Këto gjëra nuk mund të lihen më në duar të individëve me mjete të stërvjetuara. Ata e kanë kryer misionin e tyre dhe duhet të konservohen e të vendosen në muzeumet përkatës.

Nuk është e besueshme që sipas ndonjë burimi islam t'i lihet në dorë secilit musliman ta shohë hënën e re dhe të veprjë sipas asaj çka e sheh ai vetë, ashtu siç nuk mund t'i lihet vetëm një vendi të vendosë për rajonin e vet se kur do të jetë festa Islame, por nuk është e besueshme edhe kjo që kalendarit të hënës t'i caktohen ditët, paraprakisht për një vjet e të jetë gjithmonë i saktë.


Kështu mendoj për shkak se, ekspertët thonë në kalimin e hënës nga faza e katërt në fazën e parë nuk është gjithmonë diferenca kohore e njëjtë, prandaj edhe duhet pritur. Nuk mund të merret periudha që ka qenë vitin e kaluar dhe të zbatohet edhe sivjet, sepse nga muaji në muaj ka dallime.

Institucioneve islame në tërë botën u mbetet që t'i përmbahen urdhrit të Kur'anit për konsultim të ndërsjellë, të

investojnë më shumë në plotësimin e dijes përkatëse ashtu siç i obligon Allahu xh.sh. me Kur'an që vazhdimisht të mësojnë, duke pas parasysh se hëna është për llogaritje të kohës dhe për këto të shkëmbejnë informacione dhe ta informojnë opinionin e interesuar. Në kushtet e sotme kjo është një punë që

ndryshme, të ashtu quajtura me traditë historike. Le t'i kenë parasysh Librat e shpallur, hapësirën ku janë shpallur dhe të kërkojnë zgjidhje sipas tyre.

Janë absurde marrëveshjet për çështjet për të cilat nuk je kompetent. Duhet të arrihet vetëdijesimi se feja Islame ka një autoritet qendror, ai është Kur'ani, kurse vendi i tij



kryhet brenda pesë minutave dhe vetëm kështu ata e kryejnë obligimin e tyre ndaj opinionit islam. Të gjitha veprimet e tjera shpjen drejt futjes së hutimit te besimtarët islamë, demoralizojnë dhe thyejnë zemrat e tyre, sepse bota sot është shumë e vogël, ashtu që me këto veprime tekanjoze e bëjnë një familje që të mos e përjetojë festën islame si festë të përbashkët fetare, por si festë të imponuar nga faktorët politikë e ideologjikë. Duhet hequr dorë nga marrëveshja për të mos u marrë vesh. Le të bëjnë dallimin e rrethanave në të cilat ka ndodhur ndarja e Krishterimit dhe rrethanave dhe themeleve mbi të cilat është ndërtuar Feja Islame dhe të heqin dorë nga tendenca e dominimit të qendrave të

është Hixhazi. Nëse dëshirojnë të ndërtojnë qendra islame sipas modeleve të huaja ideologjike, ta dinë se bëjnë shërbim të keq dhe e devalvojnë vetëm aktin festiv, por assesi nuk do të arrijnë që ta gjunjëzojnë hënën.

Kështu si është vepruar këtë vit me këtë festë islame, opinionin islam në tërë botën ka arsye të jetë i dëshpëruar.

Edhe opinionin shqiptar është i dëshpëruar dhe kërkon me të drejtë nga paria e vet që të jenë të kujdesshëm. Mos fusin frymën e ideologjisë përçarëse në festat fetare, por t'i përmbahen frymës së Kur'anit dhe hadithit, burime nga të cilat rrjedhin porositet: *Kapuni për litarin e All-llahut... konsultohuni në punë... Bëhuni mësues ose të mësuar, por kursesi mos u bëni të tretë...*

Barazia Gjinore dhe të drejta e gruas sot

TË DREJTAT E GRAVE NË KOSOVË NJIHEN VETËM NË BAZË LIGJORE

Të drejtat e grave në Kosovë njihen vetëm në bazë ligjore, ndërsa në praktikë ato nuk respektohen dhe janë shumë larg standardeve ndërkombëtare. Amide Latifi, udhëheqëse e organizatës joqeveritare “Gratë për gratë” pohon se ligjet janë të pamjaftueshme, nëse nuk zbatohen në praktikë.

Emine VEZAJ

Megjithëse ne mund të kishim pritur që avancimi i shkencave teknologjike dhe informative në një shoqëri që kërkon përpjekje fizike në një numër gjithnjë e më të vogël të vendeve të punës do të sillte një përmirësim të ndjeshëm të të drejtave të grave, statistikat janë mjaft të qarta: që në vitet 1970, pabarazia ekonomike ndërmjet vet vendeve të botës, gjinisë dhe grupeve të tjera janë në një rritje konstante. Edhe pse kanë kaluar 60 vjet nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe 31 vjet nga Konferenca e Parë e Kombeve të Bashkuara për Gratë, edhe pse gjatë këtyre viteve janë arshivuar përpjekje të pandalshme për emancipim real të shoqërisë në mbarë botën, sërish statusi dhe pjesëmarrja e gruas mbetet një ndër problemet që kërkon zgjidhje më

lëvizur, liria për t'u shprehur, e drejta për edukim, e drejta për të punuar dhe lufta për barazi të plotë gjinore në të gjitha shtresat e shoqërisë; a thua përkrahet nga dikush, apo thënë shkurt, a ka gjetur vend të përshtatshëm? Apo ka hasur në vesh të shurdhur dhe askush nuk dëshiron që të dëgjojë për të. Për të parë se sa është duke u punuar dhe duke u mbështetur ky projekt i grave feministe në Kosovë, në Shqipëri dhe në Maqedoni, në vazhdim do të paraqesim statistikën, dhe do të nxjerrim një konkludim më të mirë rreth kësaj gjendje në të cilën po kalon gruaja e shekullit 21.

Kosova:

Përpara viteve 1990 praktikisht nuk kishte lëvizje të grave në Kosovë. Kur filluan bombardimet në 1999, sidoqoftë kishte rreth 10 organizata grash që ishin aktive. Pas luftës, numri i organizatave është rritur në mënyrë të ndjeshme duke arritur deri në 600 organizata dhe shoqata të regjistruara. Rritja e numrit të organizatave është gjithashtu një rezultat i ndihmës së huaj që është kanalizuar edhe në projekte për fuqizimin e grave në Kosovë. Shumë organizata sot punojnë për mbështetjen psikologjike të grave dhe për çështjet që lidhen me shëndetin e grave. Pika tjetër fokusuese është mbi edukimin, mbi të drejtat e njeriut, ose mbi përmirësimin e mundësive të grave për të siguruar një vend pune, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme profesionale. Së këndejmi, të drejtat e grave në Kosovë njihen vetëm në bazë ligjore, ndërsa në praktikë ato nuk respektohen dhe janë shumë larg standardeve ndërkombëtare. Amide Latifi, udhëheqëse e organizatës joqeveritare “Gratë për gratë” pohon se ligjet janë të pamjaftueshme, nëse nuk zbatohen në praktikë. “Në mesin e krejt ligjeve të cilat janë shumë pozitive dhe janë ligje shumë të mira, është edhe ligji



për barazi gjinore, i cili nënkupton dhënien e mundësive të barabarta të dy grupeve të shoqërisë, burrave dhe grave, pavarësisht nga gjinia. Megjithëse ky ligj është në letër dhe i shkruar mirë, unë nuk jam e sigurt që edhe njerëzit të cilët e kanë merituar, e kuptojnë se çka është barazia gjinore”. Edhe Ibrahim Makolli nga këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, thotë se Kosova ka ndërtuar një infrastrukturë të kënaqshme ligjore për të mbrojtur dhe realizuar të drejtat e grave, por, sipas tij, në realitet të drejtat e grave janë në gjendje diskriminuese. Por akoma më keq dhe më të fryera ndihen gratë kur ato kanë një ligj të miratuar, por që ai nuk zbatohet aspak në praktikë. S'do të duhet të habitemi sepse tek ne ende mbisundon fryma patriarkale, që nuk i ofron asaj mundësi për ta marrë këtë liri.

Shqipëria:

Shqipëria ka qenë nën totalitarizmin komunist dhe duke u nisur nga kjo ka hasur shumë vështirësi. Me ardhjen e demokracisë në Shqipëri, shqiptarët



efektive dhe një vëmendje të veçantë nga ana e çdo shoqërie dhe qeverie. Disa rajone, falë avancimeve të tyre që kanë në zhvillimin ekonomik, kanë arritur rezultate të mira, por kjo nuk është në përgjithësi. Atë formë të avancimit që sot e shohim në media, nëpërmjet shoqatave të ndryshme, që kanë të bëjnë kryesisht me problemet e grave të cilat kërkojnë të drejtat e tyre në sfera të ndryshme të jetës, siç janë; e drejta e lirisë për të

filluan të ndryshonin mentalitetin sepse atyre iu krijuan mundësi të tjera dhe iu hapën dyert e kontaktit me botën e huaj. Është ë vërtetë që ndryshimet politike influencuan në ndryshimin e sjelljes ndaj çështjeve të grave. Gjatë viteve të fundit, gratë shqiptare filluan gradualisht të fitonin kontrollin e jetës së tyre dhe, gjithashtu, filluan të jenë të pavarura ekonomikisht. Sipas kësaj reference të fundit shohim se gruaja në Shqipëri e ka parë dritën që e kërkonte prej kohësh, por në referimet që posedoj unë, has në kundërthënie më këtë që është paraqitur më lart, dhe kjo nga vet udhëheqja e Shqipërisë. Në një seancë debatesh parlamentare, pas vitit 1997, ish presidenti, lideri i opozitës, Sali Berisha iu drejtua nga podiumi një zonje kundërshtarë, se nuk e lejonte respekti për nënat dhe gratë shqiptare që ta etiketonte atë me epitetin që ajo meritonte. Gjithashtu, sipas një artikulli të gazetës “Panorama”, me titull 'Barazia gjinore', shohim se Dekreti i Presidentit për projektligjin “për barazi gjinore” nuk ka gjetur miratimin e komisionit të ligjeve. Deputet e këtij komisioni kanë dalë kundër kërkesës së kreut të shtetit për të ndryshuar projektligjin, pas një votimi pesë më katër. Edhe këshilli BE-së përfundon se Shqipëria s'ka barazi gjinore dhe se barazia gjinore nuk mbrohet sa duhet ne shoqërinë shqiptare. Kjo ka qenë një kritikë e Këshillit Evropian e shprehur në raportin e fundit të tij. Ngritja e komunitetit për mundësi të barabarta dhe miratimi nga ana e qeverisë e platformës gjinore për gratë, bazuar në platformën për veprime të Pekinit (1995), nuk janë të mjaftueshme sipas zyrarëve të Brukselit. Pra edhe pse barazia gjinore (apo shanset e barabarta, që do të duhej të quhej për trendin e kohës) dhe fuqizimi i grave konsiderohet si një çështje e rëndësishme sociale në Shqipëri, kjo, prapë se prapë, nuk ka hasur në mirëkuptimin e ndonjë institucioni vendor. Sepse nga ajo që unë dëgjoj në media dhe lexoj në revista të shumta rreth mundësive për punësim të grave, vërej se gratë kërkohen në profesione të tilla, si: pastruese, kameriere, dhe shumë rrallë sekretare, apo ndonjë profesion që do të mund ta tërhiqte femrën për punë.

Maqedonia:

Gratë në Maqedoni kanë njëfarë pozicioni të barazisë gjinore, megjithëse barazia është më shumë *de jure* sesa *de facto*. Megjithatë për sa i përket çështjes së barazisë gjinore, Maqedonia mund të

renditet ndërmjet vendeve me traditë “të gjatë” në barazinë gjinore. Sidoqoftë, ashtu si edhe në vendet e tjera të rajonit, nivelet e arritura të barazisë i kushtohen avancimeve të shpejta të emancipimit të grave gjatë periudhës socialiste, e cila ka garantuar më shumë në mënyrë deklarative, se sa praktikë, të drejtat e grave maqedonase.

Në qoftë se gratë dhe burrat janë të barabartë, atëherë atë që bën mashkulli detyrimisht duhet ta bëjë edhe gruaja si rivale e pashmangshme. Si fjala vjen, ajo duhet të jetë e pashmangshme në të gjitha detyrimet dhe obligimet e jetës. Burri duhet të jetë një mjek gjinekolog i suksesshëm, gruaja duhet të jetë e suksesshme si muratore e një ndërtese, gjithashtu ajo duhet të jetë edhe një roje burgu, por edhe një komandante lufte. Por shembulli i komandantit të ushtrisë është mjaft shembull i mirë. Kjo pozitë gjithmonë u është besuar meshkujve, edhe pse ka raste, kur edhe femrat u kanë prirë luftërave. Është fakt medicinal se gjatë kohës së menstruacioneve dhe gjatë kohës së shtatzënisë, gruaja përjeton ndryshime të rëndësishme fiziologjike dhe psikologjike. Ndryshime të tilla mund të ndodhin në kohën e situatave të mëdha mjeruese, prandaj vendimi i saj mund të jetë nën ndikimin e tronditjes. Shtrëngimi i tepërt gjatë kohës së këtyre cikleve, do të ketë efekt tjetër, nga ai që dëshirohet. Por, disa vendime kërkohen menjëherë maksimale, nevojë kjo që nuk mund të përputhet me instinktin natyror të gruas.

Duke e përfunduar këtë temë, do të dëshiroja të paraqitja konkludimin e Dragosh Kalajçi-it, në librin e tij “Islamski ustanak protiv modernog svijeta”, që të bëhet sa më e qartë se a ka mundësi apo jo, që ajo të jetë a barabartë me mashkullin, apo kjo është vetë një parullë ç'orientuese. “Po ashtu, edhe çështja e barazimit absolut ndërmjet mashkullit dhe femrës është absurde. Barazia është e pakuptimtë, po në atë mënyrë sikurse edhe diskutimi mbi barazinë e trëndafilin dhe jaseminit. Çdonjëri ka aromën e vet, formën e vet, dhe bukurinë e vet. Mashkulli dhe femra nuk janë të njëjtë; çdonjëri ka funksione dhe karakteristika të ndryshme. Femrat nuk janë të barabarta me meshkujt, pikërisht për atë shkak që as meshkujt nuk janë të barabartë me femrat. Islami i koncepton funksionet e tyre në shoqërinë muslimane jo si antagonist, por si komplementariste. Çdonjëri ka detyrat e caktuara që janë në pajtim me natyrat dhe konstitucionet specifike.

Kartolinë nga Kaçaniku

NJË COPËZ E THYER MOZAIKU

Faton ZHARKU

Makiato – si ngushëllim për veten

Sot të rinjtë kaçanikas, për shkak të papunësisë masive, janë “të detyruar” ta kalojnë kohën nëpër lokale, me pijen e preferuar makiato. Edhe pse gazetaret ditore janë shumë lirë, të rinjtë lexojnë shumë pak. Edhe ata që blejnë gazeta, më shumë humbin kohë duke u preokupuar me “VIP”-at, kronikat e zeza, horoskopët, e jo duke lexuar analiza, komente, vështrime.

Cigarja, të rinjve u “lotojnë” sytë për të

Një fjalë thotë se në varfëri bëhen tri të liga: pihet rakia, luhet kumari dhe pihet duhani. Kjo po shihet edhe në realitetin tonë, sepse shumë të rinj me të ardhurat që marrin, mezi e kalojnë muajin. Në vend se paratë e cigareve t'i shpenzojnë në diçka të hajrit, disa të rinj, me ato para “djegin” edhe shëndetin e vet, edhe e harxhojnë edhe më xhepin e zbrazët, etj.

Internet kafetë – si plotësim i dëshirave të porealizuara

Mungesa e rrymës po e rëndon jetën tonë. Madje edhe nëse je duke shikuar ndonjë emision televiziv, nuk mund t'ia dalësh në fund. Do të dalësh në qytet dhe do të hysh në ndonjë internet – kafe. Pasi të hysh në botën e interneti, apo “në fshatin e vogël të botës”, atëherë ke aq shumë alternativa sa s'di ç'të bësh. Mund që ta hapësh MSN, të hysh në dhomën e chatit, të hapësh rrjetin për kërkimin e lajmeve – google, e shumë faqe të tjera të panumërta. Fatkeqësisht disa nga të rinjtë tanë nuk e përdorin për punë të dobishme, por fokusohen në dhoma të chatit, hapjen e faqeve erotike, etj, në vend se ta përdorin për leximin e ndonjë lajmi, për të marrë informata shkencore, etj.

Fishekzjarrët – argëtimi i kalamajve

Tash në prag të Vitit të Ri, fillon kërcitja e petardave, të cilat prishin qetësinë e qytetit. A thua pse nuk nalet ky fenomen, apo pse nuk dënohen shitësit e fishekzjarrëve dhe blerësit e tyre që i hedhin kudo nëpër rrugë. Ta dimë se për çdo punë ka përgjegjësi.

Bukuritë natyrore të Kosovës

Drini i Bardhë - lumi i Rrafshit të Dukagjinit

Drini i Bardhë është lumi më i madh në Kosovë, si për nga gjatësia ashtu edhe për nga sasia e ujit. Bashkohet me Drinin e Zi në Kukës dhe formojnë Drinin (*Drillonin* që është quajtur në kohët e vjetra), derdhet në Adriatik.

Osman D. GASHI



Drini i Bardhë buron në malin e Zhlebit, i cili gjendet në pjesën verilindore të vargmaleve të Bjeshkëve të Nemuna, në majën e Rusolisë e cila ndodhet në një lartësi mbidetare prej 2381 metrash sipër

fshatit Katundi i Ri, në qytezën e Burimit (ish Istogut) në vendin e ashtuquajtur Radavc ku është edhe shpella me të njëjtin emër dhe hidrocentrali i ndërtuar mbi këtë lumë. Në këtë vend formohet një ujëvarë shumë e bukur.

Burimi i Drinit të Bardhë me shpellën dhe ujëvarën në Radavc janë marrë nën mbrojtjen e shtetit prej vitit 1983, si monument natyre. Zona e mbrojtur kap një sipërfaqe prej 89.94 ha dhe është burimi më i fuqishëm i ujit në Kosovë me

Drini i Bardhë	
Origjina	Mali Zhleb, qyteza e Burimit, Kosova
Gryka	me Drinin e Zi formon Drinin, në Kukës, Shqipëri
Vendet basene	Kosovë, Shqipëri
Gjatësia	156 km
Hap. basenit	4,964 km ²

5m³ ujë në sekondë.

Drini i Bardhë përshkon pjesën perëndimore të Kosovës, respektivisht Rrafshin e Dukagjinit me një vijë prej 156 km të gjatë, me një madhësi mbledhëse ujërash prej 4 646 km², baseni



Harta e Drinit të Bardhë dhe lumenjëve që derdhen në të

i Drinit është më i madhi nga katër basenet ujëmbledhëse të Kosovës. Drini i Bardhë së pari rrjedh në lindje afër ilixhes së Pejës dhe fshatrave Banjicë dhe Zllakuqan, ku takohet me Lumin e Istogut nga e majta dhe pastaj kthehet për në jug. Rrjedhja në vazhdim shkon përmes pjesës qendrore të regjionit tepër pjellor dhe me banim të dendur të Anadrinisë (Podrimës). Drini i Bardhë kalon disa kilometra larg qyteteve të mëdha si Peja, Gjakova, Prizreni, pastaj afër qytezës së Klinës. Fshatrat e mëdha Rugovë, Krushë e Madhe, Gjonaj, etj. janë pranë tij.

Në Drinin e Bardhë derdhen e bashkohen shumë lumenj të tjerë si: Lumëbardhi i Pejës, Lumëbardhi i Deçanit dhe Ereniku nga ana e djathtë; Istogu, Klina, Mirusha, Toplluha dhe Lumëbardhi i Prizrenit nga ana e majtë.

Është e rëndësishme të ceket se pika më e ulët e territorit të Kosovës ndodhet në luginën e Drinit të Bardhë, në kufi me Shqipërinë dhe arrin lartësinë 297 m mbi nivelin e detit.

Një prej bukurive të Drinit të Bardhë - Ura e Fshajtë

Ura e Fshajtë në kanionin e Drinit të Bardhë, e cila gjendet afër fshatit Xërxe, komuna e Rahovecit, është monument natyre me karakter hidrogjeomor-



 Burimi i Drinit të Bardhë



fologjik, me sipërfaqe prej 199 ha, dhe shtrihet në territorin e komunës së Gjakovës (73.86 ha) dhe Rahovecit (124.96 ha). Është vënë nën mbrojtje qysh prej vitit 1986. Drini i Bardhë gjatë një procesi të gjatë gjeomorfologjik ka hapur një grykë në mes dy shkëmbinjve gëlqerorë dhe formon një kanion shumë tërheqës dhe interesant për studiuesit dhe për vizitorët.

Drini i Bardhë në Shqipëri - Trektani


Pjesa shqiptare e lumit është e gjatë 19 km me një hapësirë drenimi prej 604 km². Në Trektan, nga ana e majtë, derdhet Luma që e ka origjinën prej Kosovës, nga regjioni i Gores. Përfundimisht, Drini i Bardhë bashkohet me Drinin e Zi në qytetin e Kukësit për të formuar Drinin, i cili vazhdon rrjedhjen e tij për t'u derdhur në Detin Adriatik. Pra Drini i Bardhë derdhet në Adriatik. Drini i Bardhë nuk është i lundrueshëm.

Ura e Fshajtë 



Pamje e Drinit të Bardhë te fshati Xërxe 



 Kanioni i Drinit të Bardhë gjatë stinës së dimrit



Analizë nga Bota

PËRSHKALLËZIMI I LUFTËS NË IRAK

“Fitorja në Irak është çelës për zhvillimin e lirisë dhe demokracisë në tërë Lindjen e Afërt. Ajo do të sjellë diçka krejtësisht të re - shtetin demokratik në atë rajon.”
Kështu ka thënë Bush duke publikuar strategjinë e re agresive për Irakun dhe duke pranuar përgjegjësinë e tij personale për dështimet e deritanishme në konfliktin irakian.

Ajni SINANI

Disa ditë përpara se presidenti Bush të bënte të ditur strategjinë e tij të re për Irakun duke përfshirë edhe dislokimin e mijëra trupave shtesë në Bagdad dhe ndihmat financiare për Irakun, si plani i shansit të fundit për t'i dhënë fund dhunës sektare, e cila e ka çuar vendin në prag të shpërbërjes, kryeministri irakian, Nuri El Maliki, kishte premtuar se do të ndërmerre masa ndaj grupeve të armatosura ilegale në Bagdad, në përpjekje për të përmirësuar gjendjen e sigurisë.

El Maliki kishte thënë se plani do të zbatohej nga ushtria irakiane e mbështetur nga trupat amerikane dhe do të kryhej pavarësisht nga lidhjet politike të këtyre grupeve.

Edhe demokratët në SHBA, para se Bushi të publikonte strategjinë e re mbi Irakun, filluan të ushtrojnë presion mbi të, duke paralajmëruar se plane të reja për të dërguar trupa shtesë në Irak do të përballëshin me vëzhgim të detajuar nga Kongresi që kontrollohet tani prej tyre.

Kryetarja e re e kongresit, Nancy Pelosi,



kishte thënë se Bush duhet t'i bëjë të qarta justifikimet e tij nëse do që të shtojë misionin aktual:

"Populli amerikan dhe Kongresi i përkrahin këto trupa. Ne nuk do t'i braktisim ata. Por nëse presidenti kërkon t'i shtojë numra këtij misioni, ai duhet ta justifikojë atë. Dhe kjo gjë është diçka e re për të, pasi deri më tani Kongresi republikan i ka dhënë atij çek të bardhë pa mbikëqyrje, pa standarde, pa kushte

dhe ne kemi hyrë në këtë situatë që është luftë pa fund gjë që populli amerikan e ka kundërshtuar."

Edhe përkundër paralajmërimeve të bëra nga demokratët, Bushi me rastin e publikimit të strategjisë së tij të re për Irakun, ka thënë se përparësia më



urgjente është siguria veçanërisht në Bagdad dhe provincën perëndimore të Anbarit të banuar nga sunitët.

Në një fjalim televiziv para popullit amerikan, ai konfirmoi se më shumë se 20 mijë trupa shtesë amerikane do të dërgoheshin në Irak. Mes të tjerash ai tha: "Ky është një angazhim i fortë, por që të ketë sukses, komandantët tanë thonë se irakianët do të kenë nevojë për ndihmën tonë. Amerika do ta ndryshojë strategjinë për t'i ndihmuar irakianët të zhvillojnë fushatën e tyre për të goditur dhunën sektare dhe për t'i sjellë siguri popullit të Bagdadit. Kjo do të kërkojë shtimin e nivelit të forcave amerikane, kështu që unë kam angazhuar më shumë se 20 mijë trupa shtesë në Irak, shumica e të cilave pesë brigada do të dislokohen në Bagdad."

Si shkëmbim, Bushi tha se qeveria irakiane duhet të mbajë premtimet e saj duke paralajmëruar se angazhimi amerikan nuk ishte i pafund.

Paralajmërim fqinjëve

Bushi paralajmëroi Iranin dhe Sirinë, duke thënë se ato i lejonin kryengritësit dhe armët të futeshin në Irak nga territoret e tyre dhe se Shtetet e Bashkuara do të vepronin për ta ndaluar

këtë trafik. Ai gjithashtu tha:

"Ky vit, do të kërkonte më shumë durim, sakrificë dhe vendosmëri nga populli amerikan. Fitorja nuk do të duket si në luftërat e tjera por se dështimi në Irak do të ishte një fatkeqësi për Shtetet e Bashkuara. Tërheqja tani do të sillte një rrëzim të qeverisë irakiane, do ta shkatërronte vendin dhe do të çonte në vrasje masive të një shkalle të paimagjinueshme. Një skenar i tillë do t'i detyronte trupat tona të qëndronin në Irak për një kohë më të gjatë dhe të përballëshin me një armik që do të ishte më shumë vdekjeprurës. Nëse rrisim mbështetjen tonë në këtë moment vendimtar dhe i ndihmojmë irakianët që të shkatërrojnë këtë cikël dhune, ne mund të shpejtojmë ditën kur trupat tona mund të fillojnë të kthehen në shtëpi."


Kritika ndaj strategjisë së Bushit

Ish presidenti amerikan Bill Clinton ka akuzuar administratën e Bushit për paaftësi dhe arrogancë në zgjidhjen e krizës irakiane, duke theksuar se strategjia e re nuk pasqyron përgjigjen e dëshirave të zgjedhësve amerikanë.

Fjalimi i Bushit solli kritika të menjë-



George W. Bush



hershme nga kundërshtarët e tij politikë në Partinë Demokratike. Senatori Dick Durbin tha se eskalimi i luftës në Irak nuk ishte ndryshimi që kishte kërkuar populli amerikan në zgjedhjet e nëntorit.

Senator Durbin u ankua se, duke dërguar trupa shtesë, presidenti po injoronte këshillat e shumicës së gjeneralëve të tij. Ai tha se irakianëve u duhet thënë që të marrin përgjegjësitë për sigurinë e vendit të tyre.

Kurse, demokrati Jose Serano nga Nju Jorku thotë se “Bushi sillet si bixhozçi që i ka humbur të gjitha, dhe përpiqet që të tërhiqet duke dyfishuar edhe një herë lojën. Problemi është në atë se ai luan bixhoz me jetën e njerëzve të tjerë. Problemi i Irakut nuk mund të zgjidhet ushtarakisht dhe këtë realitet Bushi duhet ta pranojë domosdoshmërisht.”

Ndërsa shumica e anëtarëve republikanë të Kongresit e mbështetën presidentin, një senator, George Voinovich, tha se ai ishte skeptik se vetëm një rritje e trupave do t'i jepte fund dhunës në Irak.

Analistë të ndryshëm shprehin dyshimin e tyre lidhur me dërgimin e trupave të reja se ato do të mund të ndryshonin situatën në Irak. Një veprim i këtillë konsiderohet si hedhje e fundit e zarit nga presidenti Bush. Edhe opiniononi i gjerë arab, edhe ai amerikan është skeptik.

Skepticizmi rreth arritjes së ndonjë suksesi me rastin e kësaj strategjie të re është shumë i qartë. Si mund të pritët që t'i jepet fund dhunës sektare e cila po rrezikon tërësinë e Irakut, kur vetë kryeministri irakian, Nuri El Maliki akuzohet nga sunitët si një udhëheqës i një qeverie fraksioniste dhe të një anshme.

Shumë gazeta arabe shkruajnë se Bushi dërgon në varrezat e Irakut edhe 21 mijë e 500 ushtarë të tjerë amerikanë. Gjatë katër viteve pushtimi të Irakut nga ShBA, janë vrarë 3 mijë ushtarë amerikanë dhe rreth 23 mijë janë plagosur.

Dërgimi i forcave amerikane shtesë në Irak konsiderohet si 'shansi i fundit' për Irakun. Bushi rrezikon që, nga kundërshtarët e tij, krahas vlerësimit të tij si njëri ndër politikanët më gënjeshtarë të vlerësohet edhe si një president i dështuar në Irak.

Nëse vërtet qëllimi i Bushit ishte sjellja e demokracisë nëpërmjet qeveritarëve që hynë në Irak me tanket amerikane, atëherë strategjia e tij duhet të vlerësohet si e dështuar. E nëse qëllimi i tij ishte shkatërrimi i Irakut dhe përçarja e popullatës së tij, vetëm në këtë rast mund të thuhet se strategjia e tij ka pasur sukses. Kundërshtarët e Bushit, arritje të vetme të tij në Irak, vlerësojnë shkatërrimin e Irakut dhe përçarjen e irakianëve në fraksione.

Gruaja dhe edukimi

EDUKIMI I FEMRAVE ËSHTË DOMOSDOSHMËRI AKTUALE

Frytet e punës në të kaluarën, kanë ardhur si fryt i punës së meshkujve dhe jo e femrave. Po pse jo nga femra? Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së arsimimit të tyre, pasi femra nuk është konsideruar e barabartë me mashkullin.

Fitim VELIU

Gruaja është themeli mbi të cilën ngrihet shoqëria njerëzore. Kur ajo inkorporohet

me burrin në një lidhje të shenjtë, atëherë vihet baza për ndërtimin e familjes, që e shpie njeriun drejt udhës së qytetërimit. Po t'i referohemi kohëve të kaluara ndeshemi me një literaturë, e cila flet për pozitën delikate të gruas. Trajtimi dhe respekti i saj i barabartë me burrin është nënvlerësuar shekuj me radhë nga burrështetas, të cilët e ndienin veten si superpushtet mbi këtë krijesë të pafajshme. Themi se kjo pozitë ka vazhduar të funksionojë deri me ardhjen e Islamit, i cili vendosi barazi ndërmjet burrit e gruas.

Në kohën para islame arabët i varrosnin vajzat e porsalindura, gjë që është një akt çnjerëzor dhe e tejkalon kodin moral dhe fetar. Ky veprim artikullohet në dy nivele: në mallkim kozmik dhe mallkim në nivelin e shkatërrimit të jetës njerëzore. Pozita e saj është përmirësuar me ardhjen e Islamit si mesazh global. Ky ishte një legjislaçion i përkryer, nga i cili gruaja përfitoi shumë, sepse ajo nuk kishte pasur kurrë me parë të drejta të cilat do të mund t'i siguronin asaj pjesëmarrje në jetën shoqërore dhe në vendimmarrje të ndryshme. Ky mesazh hyjnor, solli një frymë të re, atë të barazisë midis gjinive pa dallim. Ky mesazh, u artikulloi nga Muhammedi a.s, si ligjvënës dhe reformator, i cili solli dispozita që bazohen tek Kurani. Edukimi i gruas është esencjal, për faktin se vihen në dukje dy faktorë: gjysma e njerëzimit përbëhet nga gratë, dhe faktori i dytë është se njeriun në këtë jetë e sjell gruaja, pra njeriu lind nga to, dhe mirësjellja e saj kalon tek pasardhësit.

Shikuar nga aspekti i dije, ato mund edhe t'i kalojnë burrat. Frytet e punës në të kaluarën, kanë ardhur si fryt i punës së meshkujve dhe jo i femrave. Po pse jo nga femra? Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së arsimimit të tyre, pasi femra nuk është konsideruar e barabartë me mashkullin. Mendja e njeriut është dhuratë e të madhit Zot, mos përfitimi prej saj është faj i madh. Gruaja është e barabartë me burrin në drejtësi, detyra dhe përgjegjësi.

Edukimi i femrave është domosdoshmëri në emancipimin e shoqërisë njerëzore, sepse edukimi i gruas kalon te fëmijët si vazhdimësi e jetës njerëzore. “Edukata të cilën e fiton burri është sikur pema që mbillet për të bërë hije, ndërsa edukimi i femrës, është sikur pema e cila jep edhe hije edhe fruta” (citim nga Sami Frashëri). Të gjitha fëmijë e njohin gruan si edukatore të pazëvendësueshme në edukimin shoqëror. Edukimi i femrave është domosdoshmëri aktuale sepse ndikon në ngritjen e vlerave universale njerëzore në përgjithësi.

Histori Islame

NGA LINDJA DERI TEK REVELATA - (2)

Le të vijë nga një përfaqësues i secilit fis dhe le ta kapë xhyben që është shtrirë përtokë. Në të ai kishte vendosur Gurin e Zi. Kështu, të gjithë së bashku e dërguan Gurin e Zi deri tek këndi, në të cilin do të murosej. Kur arritën aty, Muhammedi e mori Gurin e Zi dhe e muros. Që nga ajo ditë, dera prej të cilës kishte hyrë Muhammedi u quajt Dera e Selamit (Dera e Paqes).

Muhamed Jusufi - KAJOLLI



Së pari duhet të kemi parasysh se bota njerëzore është e ndarë në besimtarë dhe jobesimtarë. Nga vetë termi 'islame' vetëkuptohet se kemi të bëjmë me ngjarjet të përshkruara nga këndvështrimi i besimtarëve. Në fakt historia ka për detyrë që t'i përshkruajë ndodhitë sa më saktë. Ajo përpiket të shkruajë çdo detaj të mundshëm, prandaj në të shumtën e rasteve do të hasim edhe disa shpjegime shtesë. Në veçanti, kur kemi të bëjmë me ngjarjet që kanë burim hyjnor, si lindjen e Isait a.s, fillimin e revelatës në shpellën Hira, apo Betejën e Bedrit, etj, të gjitha këto ngjarje janë të besueshme për besimtarët, ndërsa për jobesimtarët ato janë të pabaza. Pa marrë parasysh se cili është qëndrimi i lexuesit, ne do të përpiqemi t'i kopjojmë përshkrimet ashtu siç janë transmetuar, pastaj lexuesi le të gjykojë. Gjithashtu, në brendi të këtyre teksteve, do të gjejmë kohën e duhur për të analizuar ngjarjet sipas përshkrimeve të të dy palëve.

Familje me reputacion të lartë në shoqëri

Më 20 prill 571, sipas kalendarit të krishterë, në Mekë të Gadishullit Arabik lindi Muhammedi, i biri Abdullahut. Gjyshi tij Abdul Mutalibi ishte baba i dhjetë djemve, ndërsa Abdullahu ishte më i vogli prej tyre. Muhamedi kishte lindur pasi babai i tij kishte vdekur. Familja e Muhammedit ishte e varfër materialisht, por gëzonte autoritet të lartë në shoqërinë mekase dhe më gjerë, sepse Qabja ishte nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të kësaj familjeje. Ndërkohë që Qabeja, ishte dhe ka mbetur vendi i pelegrinazhit për të

gjithë arabët e Gadishullit dhe e muslimanëve të mbarë botës në përgjithësi.

Jetimi bashkon fiset

Për shkak të klimës më të mirë dhe ruajtjes së gjuhës së pastër, arabët e kishin zakon që foshnjat e porsalindura t'i dërgonin nëpër fshatra. Kështu Muhammedi ishte përcaktuar të rritej në familjen e Halimes. Kjo, lë të kuptohet se lindja e tij ishte krejt normale, si të gjitha lindjet e tjera të qenies njerëzore. Lindja e Muhammedit nuk është si ajo e Isait a.s., e as si ajo e Ademit a.s. Këta dy kishin lindur në rrethana jo normale, pra lindja e tyre kishte të bënte me ndërhyrjen qiellore, pra në saje të mrekullisë. Por, edhe pse lindja e tij ishte e rëndomtë, në Librat e Shenjta të mëhershme ishte paralajmëruar se në këtë rajon do të lindë një i Dërguar i Zotit...

Tek Halimja (nëna e tij prej qumështi) ai qëndroi dy vjet. Ajo sipas kontratës, pas dy vjetëve, ia ktheu djalin nënën së tij, por arriti që sërish t'ia rimerrte atë, me vetë dëshirën e së ëmës. Për shkak të një ngjarje të pazakontë dhe nga frika se këtij djaloshi po i ndodhte ndonjë gjë, Halimja e dërgoi Muhammedin para kohe tek e ëma. Në moshën gjashtë vjeçare, ai së bashku me nënën dhe gjyshin e tij morën rrugën për në Jethrib, për të vizituar varrin e babait të tij dhe për t'u njohur me familjen e nënës së tij. Në kthim të këtij udhëtimi, atij i vdes e ëma. Ai tani mbeti pa asnjërin prind. Nuk vonoi shumë kohë, dhe pas dy vjetëve i vdes edhe gjyshi i tij. Kështu, në moshën tetë vjeçare, ai kalon në kujdestarinë e axhës së tij Mutalibit. Nga kjo moshë, deri në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare, ai përmendet si bari delesh, me përjashtim të rasteve kur axha i tij, e merrte herë pas herë për tregti. Nga moshë pesëmbëdhjetë vjeçare, ai i rreket tregtisë dhe bëhet një tregtar i shquar dhe me zë. Gjatë periudhës së moshës së tij 15-18 vjeçare, Kurejshitet ishin në konflikt me fisin Havazinë, dhe Muham-


medi ishte pjesëmarrës në këtë konflikt.

Mund të themi se Muhammedi, qysh në moshën e tij të hershme, nga veprimtaria e tij e të qenit bari, mësoi se ç'do të thotë të jesh solidar, i butë dhe i mëshirshëm ndaj njerëzve dhe krijesave të tjera. Nga tregtia mësoi besnikërinë dhe amanetin. Ndërsa nga konflikti fisnor mësoi se si bëhen marrëveshjet...

Hadixhja, një tregtare e njohur e Mekkes, kishte dëgjuar për veçoritë e Muhammedit dhe kërkoi nga Mutalibi që ta punësonte Muhammedin tek ajo. Shumë shpejt u emërua udhëheqës i karvanëve të Hadixhes. Besnikëria e tij ndaj pasurisë së Hatixhes e bëri këtë të fundit që të kërkojë martesë me të.

Në moshën 25 vjeçare, Muhammedi martohet me të vejën, Hatixhen 40 vjeçare. Me të i lindën gjashtë fëmijë, (Kasimi, Zejne-pja, Rukija, Ummu Kulthumi, Fatimja dhe më i vogli Abdullahu).

Kur ai ishte 35 vjeç, Kurejshitet kishin filluar riparimin e Qabes. Por nga përfundimi i punimeve kishin filluar grindjet



dhe mosmarrëveshjet dhe desh plasi shërr. Bëhej shamatë se cili fis do të privilegjohej për ta vendosur Gurin e Zi në njërin prej këndeve të jashtme të objektit të xhamisë - Qabes. Polemika përfundoi vetëm atëherë kur njëri prej udhëheqësve dha një propozim, që u pëlqye nga të gjithë. Ai tha: ai njeri që do të hyjë i pari nga dera e quajtur: Dera e Ebu Shems-it, do ta vendosë Gurin e Zi në Qabe. Dëshira e Allahut ishte që Guri Zi të vendosej

nga Muhammedi, sepse ai hyri i pari. Muhammedi ishte shumë i mprehtë. Ai e nuhati mosmarrëveshjen që kishte ndodhur, dhe gjithashtu e kuptoi se shpëtim i grindjeve të mëtutjeshme ishte personaliteti tij. Ai e kuptoi se të gjithë të pranishmit ishin të kënaqur që ai ta vendoste Gurin e Zi. Ai nuk e bëri këtë, por ju tha: Le të vijë nga një përfaqësues i secilit fis, dhe le ta kapë xhyben që është shtrirë përtokë. Në të ai kishte vendosur Gurin e Zi. Kështu, të gjithë së bashku e dërguan Gurin e Zi deri tek këndi në të cilin do të murosej. Kur arritën aty, Muhammedi e mori Gurin e Zi dhe e murosi. Që nga ajo ditë, dera prej të cilës kishte hyrë Muhammedi u quajt Dera e

min dhe vizionin njerëzor që ishte krijuar deri atëherë. Sjelljet e tij përcilleshin me shumë vëmendje nga të gjithë, askush nuk e kish parë atë të merrte pjesë në ahengje ku pihej alkooli, e as në shtëpitë publike, e as në vendet ku luhej bixhozi etj. Ajo që kujtojnë bashkëmoshatarët e tij janë vetëm sjelljet e një personi të përkryer. Ai në mjedisin e Mekkes, para se t'i revelohej Kur'ani, njihej si njeriu më i drejtë dhe më besniku.


Në kohën kur po mbushte katërdhjetë vjet, Muhammedi kishte filluar të largohet nga shoqëria. Ai kishte një parandjenjë se jeta e tij po pësonte ndryshime. Shpella Hira ishte vendi në të cilën ai gjente qetësinë.

shumë i moshuar Verekatu bin Neufel. Ky njeri ishte i krishterë i devotshëm dhe e dinte Inxhilin përmendësh. Pasi i tregoi ngjarjen, Neufeli i tha: Ai që të është shfaqur është Meleku i revelatave (mesazhieri). I njëjti melek i ka zbritur edhe Musait a.s. Ah, sikur të isha i ri, e ta dëshmoja momentin kur do të të nxjerrin nga qyteti. Muhammedi s.a.v.s. i habitur i tha: Do të më nxjerrin?! Po - iu përgjigj. Asnjë pejgamber si puna jote, nuk ka shpëtuar pa u përzënë nga vendi, por më pas janë kthyer si ngadhënjimtarë. Duke ia sqaruar të ardhmen e tij, axha i Hadixhes nuk vonoi shumë dhe vdiq.

Pas kësaj ngjarje, ai filloi të shkonte vazhdimisht në shpellën Hira. Një ditë sërish iu shfaq po e njëjta fytyrë - Xhebraili, por kësaj radhe nuk zbriti në tokë. Ai qëndroi midis tokës dhe qiellit. I frikësuar përsëri, duke vrapuar u kthye në shtëpi dhe kërkoi nga gruaja e tij që ta mbulonte sërish. Pastaj iu shpall ajeti tjetër kur'anor që të zgjohet dhe të këshillojë. Këtë ta bënte në emër të Zotit, të Cilin duhej ta madhëronte dhe rrobta t'i pastronte...

Pas këtij momenti, Muhammedi s.a.v.s. kërkoi prej gruas dhe djalit të axhës së tij, Aliut, i cili ishte adoleshent, që ta besonin vërtetësinë e ngjarjeve të tij. Pa mëdyshje këta të dy ishin të parët që pranuan fenë e cila po lindte. Pastaj, këtë e pranoi Zejd bin Harithe shërbëtori Muhammedit s.a.v.s. Kjo thirrje nuk u ndal me kaq, ai filloi të kërkonte nga shokët e tij më të ngushtë që ta besonin. I pari prej shokëve që e besoi ishte Ebu Bekri, njëri prej shokëve më të sinqertë të tij, i cili nuk iu nda deri në vdekje. Nga thirrja e Ebu Bekrit fenë e posa njohur e pranuan: Osman bin Afani, i cili ishte njëzet vjeçar, pastaj Zubejr bin Avami, i cili njëherësh ishte edhe i afërmi i Pejgamberit s.a.v.s. dhe Hadixhes, pastaj Sead ibn Vekasi, i cili e çliroi persët nga politeizmi dhe Abdurrahman ibn Aufi një tregtar i njohur i kohës dhe shumë i sinqertë (Emri tij para Islamit ishte Abdu Omer), pastaj Talha ibn Ubejdullah, njëri prej gjashtë kandidatëve për ta zëvendësuar Pejgamberin s.a.v.s. pas vdekjes.

Pas tyre pasuan Ubejde bin Xherah, kandidati më i dëshiruar për të qenë halif pas vdekjes së Muhammedit s.a.v.s., Ekram bin Ebi Erkam i cili e shndërroi shtëpinë e tij në qendër të thirrjes në Islam. Muhammedi s.a.v.s. e predikonte Islamin në shtëpinë e tij. Kjo shtëpi, edhe në ditët tona, shërben për këtë funksion. Kjo shtëpi ndodhet në njërën prej kodrinave që janë sipër Qabes.



Selamit (Dera e Paqes).

Sjellja e Muhammedit për t'i bashkuar të gjithë, i kënaqi edhe më shumë të pranishmit. Ai edhe më parë ishte i njohur me nofken el Emin (Besniku).

Revelata Hyjnore dhe thirrja individuale

Askush, nga të dy palët, nuk e mohon faktin se Muhammedi s.a.v.s. është njeriu më i shquar i njerëzimit. Çdo detaj i jetës së tij është shkruar dhe evidentuar, veçanërisht pasi është caktuar nga Zoti si i Dërguari i Tij. Si pala injoruese, ashtu edhe ithtarët e tij, nuk kujtojnë sjellje apo veprime të këqija nga ana e Muhammedit s.a.v.s. Ai, edhe para revelatës, ishte shembull për shoqërinë. Kur atij iu ngarkua detyra për të përcjellë dhe për të bërë publike mesazhet Hyjnore, sjelljet e tij u bënë shembull për mbarë njerëzinë. Dukej qartë që ky njeri, derisa ishte ende gjallë, ndryshoi ndërgjegjen, percepti-

Në dhjetë ditët e fundit të muajit Ramazan, të ditës së hënë të vitit 610-të, gjithçka ndryshoi. Pas gjashtë muaj qëndrimi në këtë shpellë, përpara këtij të izoluar i shfaq meleku me emrin Xhebrail. Ai, kërkoi prej tij të lexojë. Përgjigja e tij ishte: Nuk di të lexoj. Meleku e kapi fort, e shtrëngoi dhe përsëri i tha të lexojë. Derisa ai e shtrëngonte, Muhammedi s.a.v.s., i përgjigjej përsëri negativisht: Nuk di të lexoj. Kjo kërkesë iu shtrua tri herë, dhe ai përgjigjej se nuk dinte të lexonte.

Pas kësaj ngjarje, Muhammedi iu drejtua Mekkes. I stresuar dhe nën ndikim e etheve nuk foli me gruan e tij. Asaj i kërkoi vetëm që ta mbulonte. Pasi u zgjua, i tregoi asaj çfarë i kishte ndodhur. Pa hamendjen më të vogël Hadixheja i tha: nuk mendoj se të ka kapluar ndonjë kob i zi, sepse ti askujt nuk i ke bërë keq. Këshilla e saj ishte që Muhammedi së bashku me të, të shkonte tek axha i saj

Refleks mbi Kulturat

LUFTA E NXEHTË

Është e lehtë të shihet tendenca e oksidentalëve për superioritet, të cilët, duke mos e vlerësuar drejt kulturën orientale, pra edhe muzikën orientale, shkojnë deri atje sa çdo tingull oriental ta vlerësojnë si shund e kiç. Dhe kjo, sigurisht, e ka bazën në *Luftën e Nxehtë*, përndryshe *shund e kiç* është bastardimi i muzikës orientale, që vjen nga paaftësia e oksidentalëve për t'i kapur esencat e shpirtit oriental.

Ag APOLLONI

Aktualisht është tejet evident fakti i diferencimit të dy kulturave të mëdha, Orientale-Oksidentale, të cilat ashiqare janë në *Luftë të Nxehtë* me njëra-tjetrën. Me *Luftë e Nxehtë* këtu kuptohet lufta për vlera estetike dhe etike (kultura emocionale-shpirtërore e të dy anëve), porse nuk përjashtohet as aludimi në luftën ekonomike, e cila vishet me petkun politik. *Lufta e Nxehtë* konoton debate të zjarra dhe pasoja të përgjakta. Ajo zhvillohet e motivuar nga esencat e civilizimit, siç janë estetika dhe etika, që janë specifika të njeriut.

Kur flitet për *Luftën e Nxehtë*, zakonisht objekt bëhet pjesa më e ndeshme kulturore e njeriut qoftë oksidental, qoftë oriental. Prandaj edhe tendenca për superioritetin e kulturës oksidentale kundrejt asaj orientale, rezulton me grindje dhe masakra. Kjo mund t'i prijë arsyesimit, që mund dhe s'mund të jetë fatal, për veprimin makabër si veprim për vetëmbrojtje. E dihet se në kurriz të vetëmbrojtjes justifikohen edhe veprimet antihumane.




Gjithsesi nuk duhet anashkaluar fakti se lidhja emocionale e njeriut me kulturën të cilën e përfaqon/përvetëson me dëshirë, është *lidhje e nxehtë* dhe ka tabutë e veta, të cilat nuk është e

lejueshme të kontestohen, e lërë më të preken. Pikërisht kjo zjarrmi e njeriut në lidhje me mbrojtjen e vlerave shpirtërore, siç janë arti dhe religjioni, konsiston në vendosmërinë e tij për të refuzuar nënshtrimin shpirtëror, nga i cili derivon spastrimi emocional dhe tjetërsimi emocional. Arti dhe feja janë vlera supreme shpirtërore të njeriut, prandaj edhe vetëm tendenca për asimilimin e tyre është absurde, por s'janë absurde veprimet ekstreme, çfarëdo qofshin ato, për mbrojtjen e tyre. Përkundrazi, sfida e njeriut për të qenë autentik dëshmon imunitetin e tij për të përballuar virusin dekulaturalizues të futur në mënyrë morbide, ose ashiqare brenda aksh domeni kulturor, i cili nuk ka nevojë për këshilla nga jashtë, sepse është vetvetiu gjenerues.

Hendeku mes Kulturës Oksidentale dhe Kulturës Orientale është mjaft i madh dhe i rrezikshëm. Është një pakicë e njerëzve të kulturës që merren me ndërtimin e një ure mbi këtë hendek, por gjithashtu është edhe një shumicë që pengon konsolidimin e kësaj ure shpirtërore. Dhe vetë fakti se lejohet ndërtimi i një ure të tillë, pohon se këto dy kultura nuk kanë qëndrim refuzues ndaj njëra-tjetrës, por kanë qëndrim refuzues ndaj veprimeve për epërsi të njëres ndaj tjetrës. Kjo vlen vetëm për artin, por jo edhe për religjionin, i cili shpërfill çfarëdo ndikimi nga religjioni tjetër. Pra, në këtë aspekt, religjioni është lidhje më e nxehtë, sepse është mbrojtje e konventës, sipas së cilës kërkohet besim/bindje, ngaqë edhe vetëm pyetja mbi ekzistencën apo mosekzistencën e Zotit, nga besimtarët konsiderohet një formë e blasfemisë. Si i tillë, religjioni është i pakompromis dhe mund të merren me mend pasojat në rast kontestimi të tij, apo në rast të influencimit në të.

Ndryshe qëndrojnë punët me artin, i cili



gjithashtu është vlerë shpirtërore, që nuk e përjashton karakterin intermediar të tij. Madje ai e afirmon këtë karakter, që është pozitiv për të.

Interesant është të shihet se si konceptohet muzika orientale nga oksidentalët. Është lehtë të shihet tendenca e oksidentalëve për superioritet, të cilët, duke mos e vlerësuar drejt kulturën orientale, pra edhe muzikën orientale, shkojnë deri atje sa çdo tingull oriental e vlerësojnë si shund e kiç. Dhe kjo, sigurisht, e ka bazën në *Luftën e Nxehtë*, përndryshe *shund e kiç* është bastardimi i muzikës orientale, që vjen nga paaftësia e oksidentalëve për t'i kapur esencat e shpirtit oriental.

Tendencën për dominim të perëndimorëve ndaj lindorëve e zbusin në mënyrë të lakmueshme personalitete të muzikës, si: Sting, Peter Gabriel, Madonna etj., njëri prej të cilëve (Sting), ka përfaquar edhe filozofinë orientale, përkatësisht religjionin budist.


Natyrisht se Lufta e Nxehtë vazhdon dhe do të vazhdojë, por që tash ajo ka emër. E pagëzimi nënkupton prezencën e vetëdijes sonë mbi gjërat që na rrethojnë, apo që na preokupojnë. Pagëzimi është një lloj hapje debati mbi një problem, për të cilin nuk mund të debatohej, pasi nuk i dihej emri.

Histori kombëtare

VEPRIMTARIA E MYDERRIZ JUSUF PODGORICËS NË RRJEDHËN E LËVIZJES KOMBËTARE

Myderrizi Jusuf Efendi Podgorica, sipas konfirmimeve të publicistit Jusuf Buxhovi, “po thujse çdo dy-tri ditë i dërgonte (Kongresit të Berlinit) nga një telegram apo protestë”, të nënshkruar me mbiemrin Ziadini, të cilin e kishte për mbiemër në postin e parlamentarit osman.

Muhamet PIRRAKU



Një ndër personalitetet e rëndësishme në rrjedhë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, është, pa dyshim, Myderriz Jusuf Efendi Uruçi - Pogorica. Fillet e veprimtarisë arsi-

more, juridike dhe politike atdhetare të tij nisën në kohën kur po kulmonte Kriza Lindore, e cila paralajmëronte shembjen definitive të Perandorisë Osmane para armëve të aleancës së krishterë imperia-liste të fuqive të vendosjes: Anglia, Gjermania, Rusia, Franca, Austro-Hungaria dhe Italia. Fakti që është zgjedhur deputet i Vilajetit të Shkodrës në Parlamentin e Parë Osman, të viteve 1877/78, flet bindshëm se myderrizi Jusuf Efendia i përkiste elitës së veprimtarëve të “Bashkimit të Ri Osman” (Yeni Osmanli Cem’iyyeti), bartës të kërkesave për decentralizimin dhe demokratizimin e shoqërisë osmane mbi bazën e Kushtetutës së shpallur nga Sulltani, më 23 dhjetor 1876.

Përpyjekja politike e pashembullt e Myderriz Jusuf Efendisë në Parlamentin Osman, për të reflektuar me kompetencë politike, diplomatike dhe ushtarake mbi rreziqet e copëtimit të Shqipërisë (së këndejmi edhe të Perandorisë Osmane), angazhimet vetëmohuese të hoxhë Jusufit për farkëtimin e unitetit të faktorit politik dhe ushtarak shqiptar, veçanërisht midis elementeve fetare dhe krahinore përbërëse historike të këtij kombi, si dhe reflektimet e tij, të themi me dinjitet historik, me telegrame, peticione e kërkesa programatike kombëtare shqiptare mbi çështjen shqiptare në radhët e përfaqësuesve të Kongresit të Berlinit, - kundër zgjerimeve me aprovim ndërkombëtar të Serbisë, të Malit të Zi, të Bullgarisë dhe të Greqisë me vise pjesëpërbërëse etnike dhe

historike të Njësisë Etnokulturore dhe Gjeopolitike të Shqipërisë (Arnautlluk, Albania, e cila në prag të hyrjes së Rasisë kundër Perandorisë osmane, më 24 prill 1877, kishte rreth 114.728 km²), Myderriz Jusuf Efendi Podgoricën e radhit në pararendës të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të Lagjes së më të famshmeve: Myderriz Ymer Efendi Prizrenit, Abdyl be Frashërit, Jusuf Efendi Sokolit, dhe të Sylejman be Vokshit, gurë këta qoshnikë në godinën: Lëvizja Kombëtare Shqiptare, e cila kurrë më nuk pushoi dhe do të vazhdojë rrugëtimin me legjitimitet historik deri në ditën e realizimit të kërkesave jetësore të qenies së kombit shqiptar-komb i bashkuar, si vëlla me kombet e tjera në Evropën e lirë.

Legjitimitetin e Myderriz Jusuf Efendi Podgoricës për të gëzuar përjetësisht respektin e brezave shqiptar e mbështet fuqimisht edhe prejardhja e tij nga një vëllazëri shqiptare etnike podgoricase, që dha dijetarë islamë të fisnikëruar me shqiptari dhe luftëtarë të shquar për lirinë e kombit shqiptar nga brezat paraardhës në Podgoricë dhe nga brezat pasardhës në Shkodër. Nga të dhënat e vjela nga burimet dhe kujtesa historike mund të vërtetohet se vëllazëria e shquar Uruçi e Podgoricës, të cilën në piedestalin e Altarit të Atdheut Shqipëri e daltoi Myderriz Jusuf Efendia, vinte nga vëllazëria mesjetare Margilaj e Trijeshit, por në këtë fazë të njohjes nuk dimë për kohën e vendosjes në Podgo-ricë. Vërtet, me të dhëna të tërthorta mund të thuhet se ajo në kapërcyellin nga shekulli XVII në shekullin XVIII, ishte atje, njëra ndër familjet intelektuale pod-goricase në gjirin e së cilës kishte dijetarë të shquar, të vënë në shërbim të fesë dhe të civilizimit islam ndër shqiptarët, në funksion të fisshëm të ndërprerjes së procesit të sllavizimit të shqipfolësve ortodoksë, heretikë bogum-ilë dhe katolikë me ndërmjetësimin e kishës ortodokse shënsaviane institucionale osmane.

Një e dhënë burimore nga 5 qershori 1647 flet për ekzistimin e një Jusuf Efendisë, myezin në Xhaminë e Kalasë së Podgoricës, kurse në vitin 1714 përmendet alimi Jusuf Podgoriçanin, si imam” (udhëheqës në faljet kolektive të besimtarëve islamë) dhe hatib (predikues islam të premtëve dhe në ditët e Bajramit) në “Xhaminë e Glavatoviqit”. Meqë e dimë saktësisht se Myderriz Jusuf Efendi Uruçi - Podgorica ishte pinjoll i largët, në tri apo katër breza i alimit Jusuf Podgoriçaninit, duke pasur parasysht traditën shqiptare të trashëgimisë së emrave në familje, mund të supozojmë se (nëse në Jusufin e vitit 1647 dhe në Jusufin e vitit 1714, nuk kemi të bëjmë me të njëjtin veprimtar kulturor islam, në rini si myezin dhe në pleqëri si alim), në këta dy Jusufa kemi dy veta me lidhje gjaku, paraardhës të Myderriz Jusuf Efendi Uruçit - Podgoricës.

E dhëna që la Jusuf Podgoriçaninit për vetën, flet fuqishëm për ekzistimin e vëllazërisë intelektuale Uruçi në Podgoricë, me kredibilitet shkencor të shquar në lëmi të fesë dhe të drejtësisë islame. Alimi Jusuf Podgoriçanin, e përfundoi përshkrimin e “Përmbledhjes së Zgjidhjeve Juridike sipas Sheriatit”, të autorit Myfti Ibrahimit të Budimit, më 6 qershor 1714. Kaligrafia shumë e bukur, e tipit ta-alik duktus, flet për një kaligraf të stërvitur mirë në punë përshkrimi të dorë-shkrimeve dhe të librave të rrallë, i cili duhej të kishte bërë emër edhe në lëmë të drejtësisë, më së paku nga fundi i shekullit XVII, kur Islami ndër shqiptarët ishte bërë fe dhe civilizim i shumicës shqiptare, si faktor i rëndësishëm në rrjedhat e integrimin dhe të ruajtjes së njësisë etnokulturore të Shqipërisë.

Nga fundi i shekullit XVII dhe në pjesën e parë të shekullit XVIII në Podgoricë veptoi dijetari me ndikim të madh në mjedisin jetësor, Haxhí Ibrahim Efendi Rustem Uruçi, udhëheqës shpirtëror i komunitetit islam të Podgoricës dhe

luftëtar i shquar në përballimin e inkursioneve malaziasë në viset shqiptare. Myderriz Jusuf Efendi Ibrahim Rrustem Uruçi- Podgorica, të cilin po e përkujtojmë dhe nderojmë sot, është i biri i tij.

Në këtë fazë të dijës nuk mund të flasim saktësisht për vitin e lindjes as për vitin e vdekjes, për faktin se ndriçimin e jetës dhe të veprës arsimore, kulturore dhe shkencore të këtij personaliteti - Fanar i shqiptarësisë së Podgoricës në kohën e tij, të themi qartë: nuk është marrë asnjë studiu i historisë dhe i kulturës shqiptare. Myderrizi Jusuf Efendia, në kohën e veprimtarisë së tij të lavdishme për kombin, nuk ishte intelektual i vetëm i vëllazërisë Uruçi. I kësaj vëllazërie, kushëri i parë i Jusufit ishte Myderriz Hasan Efendi Podgorica (rreth vitit 1830 - 1901), gjykatës në Shkodër më 1871, myderriz i Medresesë së Pazarit, dijetar dhe krijues i shquar në dituritë islame e të Sheriatit. Në vitin 1881, rreth tri vjet pas rënies së Podgoricës nën Malin e Zi, myezin në "Xhamisë së Gllavatoviçit" ishte Haxhi Selo Oruçeviq, i biri i madh i Jusuf Efendi Uruçi - Podgoricës.

Myderrizi Jusuf Efendi Uruçi - Podgorica duhet të ishte si motak me kushëririn Hasan Efendi Uruçi. Sipas kujtesës në Shkodër, e konfirmuar nga urtaku Mujo Dervanoviq, në maj 1982, Jusuf Efendi Uruçi u shpërngul në Shkodër dy ose tri vjet pas pushtimit malazias të Podgoricës, në moshën rreth 50 vjeç. Së këndejmi del se Jusuf Efendi Ibrahim Rrustem Uruçi- Podgorica duhet të ishte i lindur rreth vitit 1830 ose 1831. Kjo datë sikur korrespondon me moshën rreth 47-48 vjeç, që reflekton fotografia e 30 qershorit 1878, në gjirin e Delegacionin të Shkodrës - në nisje për në Kuvendin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Mirëpo, sipas kujtesës së shkodranit rreth 100-101 vjeç, Mahmut Dajbabit (Buto Kundraxhaja), konfirmuar më 14 prill 1978, Jusuf Efendi Podgorica ishte më i moçëm. Ai, midis të tjerave, ka konstatuar se: "Në moshën 13-14 vjeç, para 87 vjetëve, kam shkue me jetue te Jusuf Efendi Podgorica ose Uruçi dhe të biri i tij (i tretë) Sala. Kam kenë i varfën dhe më kanë mbajt ata e më kanë ba si djalë të shtëpisë. Në atë kohë Jusufi ka qenë rreth 70 vjeç. Unë kam jetue me të rreth 3-4 vjet, kështu që ka vdekë në moshën rreth 73-74 vjeç", që do të thoshte më 1894 ose 1895.

Të dhënat e mbledhura pikë-pikë flasin qartë se Jusuf Efendi Uruçi mësimet e

para i mori nga i ati, mualimi dhe alimi i madh, Haxhi Ibrahim Rrustem Efendia Uruçi, kurse në Medresenë e Qafës (themeluar nga Mustafë pashë Bushati), e mbaroi shkollimin e mesëm, të myderrizi i njohur në traditën shkodrane me atributin: Sali Efendia i Madh, përkatësisht mualimi (pedagog), alimi (dijetar) dhe bejtexhia (poeti) satirik Mulla Salih Pata - Kasti i Shqipërisë i Oborrit të Mustafë pashë Bushtit famëlartë. Studimet në lëmë të fesë dhe të sheriatit Jusuf Uruçi i mbaroi në Stamboll.



Pas përfundimit të shkollimit Myderriz Jusuf Efendi Uruçi u kthye për të shërbyer në vendlindje, në Podgoricë. Krahas gjuhës së mëmës, e njihte bukur edhe gjuhën boshnjake, turqishten, arabishten e persishten dhe kjo bëri të shquhet me dituri në lëmë të teologjisë dhe të drejtësisë. Kishte mendjemprehtësi dhe guxim intelektual të pashoq. Në prag të shkallëzimit të Krizës Lindore (kur rreziku i pushtimit malazias në Podgoricë dhe në viset të tjera të Vilajetit të Shkodrës po trokiste me tërbim), konsiderohej si njeriu i parë me autoritet suprem në Podgoricë, myfti i vendit dhe pedagog i shquar në lëmë të "Të së drejtës trashëgimore sipas Sheriatit". Njëkohësisht shërbente si myzefit - interpret dhe udhëzues për zgjidhje juridike të çështjeve, ndaj u quajt edhe me atributin: Jusuf Efendi Fetfahia.

Të gjitha këto që u thanë përmbledhtazi flasin se Jusuf Efendi Podgorica është zgjedhur deputet i Vilajetit të Shkodrës, përfaqësues i Podgoricës, me merita e kompetencë të pa precedentë. Sipas të

dhënave të njohura deri tashti, ai në Parlamentin osman shkoi me emri "Podgoriceli Jusuf Ziyaeddin efendi" dhe nga tribuna foli mase tri herë; në fillim të prillit, më 20 qershor dhe më 25 dhjetor 1877. Eruditi Hamdi Bushati në librin "Shkodra në Mote", midis të tjerash, konstatoi: "Deputeti i Podgoricës, Jusuf Efendia, i cili me oratorinë e tij kumbuese që dallue në mes deputetëve shkodranë dhe të tjerëve në parlamentin e parë turk, me fjalimin e tij elokuent diti t'i mbrojë shumë bukur kufijtë e Shqipërisë së asaj kohe (...). Jusuf Efendia qe një hoxhë i ndritun, orator, guximtar, personalitet me ndjenja të forta patriotike; qe solidar me ndjenjat e gjithë popullit shqiptar dhe dha kushtrimin e tij të zjarrtë, tue paralajmëruë rrezikun e cungimit të tokave shqiptare para parlamentarëve të Turqisë. Ai parashihë kryengritjen e Mirditës dhe zmadhimin e saj në gjithë Shqipërinë, tue u frikësue se nga kjo kanë me fitue malazeztë(...)".

Ka edhe historianë, si Xhafer Belegu e të tjerë pas tij, që kanë lënë konstatime të vyera për veprimtarinë politike patriotike të Jusuf Efendi Podgoricës në Parlamentin Osman. Mirëpo këtu le të më lejohet të shkëpus disa konstatime në librin: "Myderriz Ymer Prizreni - Ora, zemra dhe shpirti i Lidhjes Shqiptare 1877-1887", ku, për rolin dhe rëndësisë e Myderriz Jusuf Uruçit - Podgorica, midis të tjerash, kam konstatuar: "(...)

Rrezikut të Shqipërisë Veriore nga pushtimi shkretë-rues malazias do t'i qaset, me njohuri të thella, me vigjilencë politike dhe me disidentizëm patriotik shqiptar, përfaqë-suesi i Vilajetit të Shkodrës, myderrizi i famshëm, Jusuf Efendi Podgorica Uruçi (...). Deputeti urtak dhe i guximshëm, Jusuf Efendi Podgorica, kritikoi komandantët dhe ushtrinë perandorake osmane për paaftësinë e dëshmuar, me të gjitha parametrat e tradhtisë ndaj Atdheut Perandorisë Osmane në përgjithësi dhe Shqipërisë në veçanti (...). Fjala e deputetit të Shkodrës, Jusuf Efendi Podgoricës në Parlamentin Osman, më 25 dhjetor 1877, ishte vërejtja dhe paralajmërimi më dinjitoz që iu bë Parlamentit, Portës së Lartë dhe Sulltanit, por edhe Shqipërisë katërçipërisht, se "po që se një pëllambë vend i lëshohet Malit të Zi, do me thanë i asht lanë edhe Shkodra atij(...)". Dhe, më tutje, (...) denoncoi si të dëmshme, katastrofik dhe të parealizueshëm opinion politik qeveritar osman për sistemimin e popullsisë shqiptare të

vendeve të rrezikuara nga okupimi malazias në vende të tjera në thellësi të Perandorisë Osmane. Me një gjykim politik e kombëtar vërtet të shëndosh, si dhiatë për bashkëkohësit dhe për brezat shqiptarë (...)."

Myderrizi Jusuf Efendi Podgorica, sipas konfirmimeve të publicistit Jusuf Buxhovi, "po thuajse çdo dy-tri ditë i dërgonte (Kongresit të Berlinit) nga një telegram apo protestë", të nënshkruar me mbiemrin Ziadini, të cilin e kishte për mbiemër në postin e parlamentarit osman. Sipas gjithë gjasash, ky ishte emër i ndonjë paraardhësi në degën gjenealogjike deri të dijetari Jusuf Podgoriçanin (1714): Muderriz Jusuf Efebndiu - Ibrahim - Rustemi - Ziadini - Jusufi - Uruç Podgoriçanin. Kjo gjenealogji do prova shtesë.

Përpyekjet me shumë sakrificë të Myderriz Jusuf Efendi Podgoricës, për të marrë në mbrojtje tërësinë e Shqipërisë nuk dhanë rezultate. Kombi shqiptar as Perandoria Osmane, së bashku as veç e veç, nuk e kishin forcën reale për të përballuar një luftë të orkestruar nga aleanca e kryqit, që lidhi të gjitha Fuqitë e Mëdha Evropiane dhe shtetet ballkanike satelite të tyre. Në janar të vitit 1879, struktura të caktuara të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit iu shtruan kërkesave të Kongresit të Berlinit për heqjen dorë nga Podgorica, Shpuza dhe Zhabjaku, si vende me popullsi të përziera, në dobi të ruajtjes së Plavës e të Gucisë, të banuara me shumicë shqiptare. Pas Marrëveshjes turko-malaziasë për kufi, të 2 shkurt 1879, Podgorica me viset përreth do të kalojë nën administrimin ushtarak të Malit të Zi dhe kjo e goditi rëndë dinjitetin patriotik të Myderriz Jusuf Efendi Podgoricës.

Nga kjo kohë, në fille të robërisë malazeze, vetëm edhe një herë e shohim në një aktivitet politik publik në vendlindje. Në mars të vitit 1879, Vojvoda Mark Milani organizoi vrasjen e kreut podgoricas me autoritet të madh, Jusuf Muç Kërniqit. Atë e vrau Pera Popoviq, rrogëtar shumëvjeçar i Muçit. Qytetarët e Podgoricës dhe të Tuzit u ngritën në revoltë për gjakmarrje doradorës, me ç'rast do të vriten edhe të pafajshëm. Myftiu Jusuf Efendi Uruçi, duke nahuat faktin se pushteti ushtarak malazias po përgatitej për një gjakderdhje masive ndaj shqiptarëve, vërtetë kundër shqiptarësisë së Podgoricës me rrethinë, ndërhyri me shpejtësi, guxim dhe dinjitet, ndërpreu

gjakderdhjen dhe e ktheu qetësinë dhe paqen në vend.

Sipas njohësit të kthjellët, Mahmut Dajbabit, "autoritetet turke të asaj kohe e kanë lut me shkue në Stamboll, por nuk ka dëgjue se nuk ka dashtë me u largue nga vendi i vet". Në anën tjetër, "autoritetet malazeze e kanë lutur të qëndronte në Podgoricë, duke i ofrue shtëpi, rrogë të majme dhe ofiqe". Mirëpo, gjithnjë sipas kujtesës historike, Myderriz Jusuf Efendi Uruçi e refuzoi kërkesën e Knjaz Nikollës - të dërgonte fëmijët në shkollat në gjuhën serbe! Kjo konsiderohet shkak për ikjen e tij nga



vendlindja, duke marrë me veti një pjesë të familjes së ngushtë dhe bibliotekën që kishte rreth 8000 volume. Meqë ishte personalitet i respektuar nga qarqet e pushtetit osman dhe atyre vendore, në Shkodër iu besua administrimi i Mirazeve (Ndihmat për popullin).

Për jetën e Myderriz Jusuf Efendi Uruçit në Shkodër kemi vetëm të dhënat modeste nga kujtesa e urtakut Mahmut Dajbabi, i cili ka konstatuar: "Jusufi ka qenë një njeri i shkathët me trup mesatar dhe shumë i ndrojtur (...)". Konstatimi "shumë i ndrojtur" duhej të vihej në lidhje me faktin se Myderrizi Jusuf Efendia e kishte familjen e gjerë dhe një pjesë të familjes së ngushtë në Podgoricë. Djalë e madh, Mulla Selo, e kishte myezin të Xhamisë së Glavatoviqit. Sipas Mahmut Dajbabit Myderrizi Jusuf Efendia "ndër biseda gjithmonë fliste për kufijtë shqiptarë dhe jepte edhe fakte për këtë. Ka kenë një njeri i urtë dhe inteligjent. Ka zgjidhë hallet e njerëzve. Studionte vazhdimisht libra të ndryshëm historike dhe fetare. Ka qenë një njeri me influencë të madhe në qytetin e Shkodrës

dhe të Podgoricës. Ka pas një bibliotekë shumë të madh të mbushur edhe me libra historikë dhe shkencorë të asaj kohe, kryesisht në gjuhën arabe dhe turke. Mbaj mend se kanë ardhur edhe nga vendet e Evropës tek ai me ble libra nga biblioteka e tij, por nuk i shiste. Ka qenë një njeri i drejtë dhe i sqtë. Njerëzit shkonin dhe pyesnin për të gjitha hallet e tyre (...). Në vdekjen e tij ka marrë pjesë një numër shumë i madh njerëzish edhe nga vegjëlja e qytetit".

Sipas kujtesës së konfirmuar nga Mujo Dervanoviq, "Kur ka vdekë Jusuf Efendia një njeri i përmendur i kohës, që nuk ja mbaj mend emrin, ka thanë tek vorri i tij: "Sot kena fut në dhe Sheriatin". Ky "njeri i përmendur i kohës" ka mundur të ishte myftiu zulmadh Jusuf Efendi Tabaku (1797-1904), i njohur në popull me ofiqin: "Myfti Plaku", më të cilin Jusuf Efendia ishte në shoqëri të panda-shme së paku në vitet 1881-1895.

Myderrizi famëmadh, Jusuf Efendi Uruçi Podgorica, pas vetës la katër djem: Selon, Beqirin, Salon, Ethemin dhe vajzën Hato. Kjo vdiq e re, rreth vitit 1900. Të gjithë fëmijët kishin njohuri në dituritë fetare, kurse Beqiri ishte një hoxhë, patriot dhe udhëheqës luftarak i dëshmuar në luftë kundër ushtrisë pushtuese serbo-malaziasë, si në Luftën e Tuzit e gjetkë. Pas vdekjes së tij, më 1918, nderin e familjes Uruçi e shpini përpara i biri i tij, Muhamet Uruçi, mësues antifashist, kujtimin me pietet për të cilin e ruan Gjakova antifashiste nga vitet e Luftës së Dytë Botërore. Ishte sekretar i SKOJ-it për Qarkorin e Gjakovës.

I biri i mësues Muhametit, Dashmir Uruçi, eminenca e kaltër e Shoqatës Atdhetare Kulturore "Kosova" të Shkodrës, në periudhën e kthesave të mëdha politike në Shqipëri - në vitet e Epokës së UÇK-së, me punë e sakrificë maksimale na sollti këtu, në këtë ditë të sotme kur për të parën herë, në mënyrë institucionale shtetërore po e përkujtojmë Madhorin e Kombit - Jusuf Efendi Uruçin Podgorica, me "Medaljen e Mirënjohjes", të akorduar nga Presidenti i Shqipërisë, Z. Alfred Moisiu, me motivacion: "Për kontributin e vyer si deputet i Vilajetit të Shkodrës në Parlamentin e Parë Osman, në mobilizimin e popullit për mbrojtjen e tërësisë së trojeve shqiptare".

Ai është hero i gjallë i kombit. I qoftë i lehtë dhe i Nënës Shqipëri të përgjakur në rrugën e gjatë për t'u ribashkuar, duke pasur shembull të gjallë sakrificën e Myderriz Jusuf Efendi Podgoricës.

PËR AMERIKËN KA SHUMË MË TEPËR NË LOJË SE IRAKU

Kjo duhet gjithashtu të angazhojë aleatët e saj në një përcaktim të përbashkët të parametrave bazë të një marrëveshjeje izraelito-palestineze, meqenëse të dyja palët në konflikt nuk do të arrijnë kurrë që ta bëjnë vetë këtë. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, SHBA duhet të jetë e gatshme të vazhdojë bisedime multilaterale dhe bilaterale me Iranin, përfshi edhe çështjet e sigurisë rajonale.

Zbigniew BRZEZINSKI

Kjo është java në të cilën një e vërtetë e dhimbshme më së fundi ka radhën për të shtuar presionin në Zyrën Ovale të Shtëpisë së Bardhë. Presidenti, megjithëse vazhdon të shqiptojë sloganet e vetesiguruese për publikun, do të ketë në tavolinën e tij dy dokumente, secili prej të cilëve do t'i thotë në fakt se "misioni i përfunduar" është kthyer në një mision të dështuar.

Sipërfaqësisht, dy dokumentet nuk kanë mundur të jenë më shumë të ndryshme. Memo e Donald Rumsfeld mbi drejtimin e operacioneve ushtarake në Irak, e paraqitur vetëm pak përpara dorëheqjes se tij të papritur, është një përmbledhje shumë e shkurtër dhe shumë personale e rregullimeve të ndryshme taktike që mund të merren në konsideratë, duke marrë parasysh pengesat në luftimet me rebelët në Irak. Ajo mbart shqetësim, por nuk ofron asnjë alternativë strategjike.

Raporti i shumëpritur i Grupit të Studimit Bejker-Hamilton, duke vlerësuar opsionet e plota të politikës amerikane në Irak, është një ekspozë e gjatë kompromisi, duke reflektuar një konsensus të moderuar midis një "grupi elite" të Uashingtonit, të përberë nga individë të nderuar që nuk janë të penguar nga një familjaritet shumë i madh historik ose gjeopolitik me problemet e rajonit. Duke folur në favor të një ridislokimi të kondicionuar ushtarak nga Iraku, ai ofron këshilla të shëndosha mbi dëshirueshmërinë e iniciativave më të gjera diplomatike për të angazhuar fqinjët e Irakut në një kërkim kolektiv për stabilitet rajonal, përfshi nevojën e vonuar për t'u përballur seriozisht me konfliktin e hershem izraelito-palestinez.

Rëndësia e vërtete e të dy dokumenteve është në atë që ato nuk e thonë në mënyrë eksplicite, por që padyshim përçojnë: se lufta ka qenë një katastrofë; që SHBA duhet të gjejnë një mënyrë për t'u

shkëputur, duke ia dorëzuar rrëmujën që ata krijuan liderëve irakenë, të cilët vetë amerikanët i kanë ngritur në pushtet; dhe që eventualisht SHBA mund t'u duhet të largohen, ndërsa fajësojnë disa prej këtyre liderëve për dështimin e bashkëpunimit me amerikanët. Kjo pikëpamje është nënkuptuar edhe në disa prej opsioneve të z.Rumsfeld dhe kjo është e pandryshueshme në afatin prej 16 muajsh të vendosur nga grupi Bejker-Hamilton për një tërheqje eventuale ushtarake amerikane.

As njëri dokument, as tjetri, nuk përballet me dy realitete themelore dhe shqetësuese: që përderisa në Irak (përveç Kurdistanit) fuqia reale nuk është në duart e politikaneve irakenë rezidente në Zonën e Gjelbërt të Bagdatit të mbrojtur nga amerikanët, çdo zgjidhje politike duhet të angazhojë teokracinë shiite, me milicinë e saj; dhe sa më gjatë që të vazhdojë pushtimi amerikan, influenca amerikane tashme në rënie në Lindjen e Mesme do të zmbrapset, duke i lënë tashmë rrugë ekstremizmit rajonal dhe paqëndrueshmërisë, veçanërisht në qoftë se pavendosmëria e vazhdueshme mbi alternativat themelore strategjike në Irak do të vazhdojnë të jetë ballafaquar me mosdashjen amerikane për të drejtuar pasojat negative rajonale të pushtimit të zgjatuar dhe gjithnjë e më shumë represiv të palestinezëve nga Izraeli.

Kombinimi i këtyre të dyjave ka rritur tashme fuqinë gjeopolitike të Iranit në rajon. Kështu që nevoja e momentit nuk është për kallajisje taktike ose raporte të gjata konsensusi. A mundet që ndokush të imagjinonte Charl de Golin në fundin e viteve '50 të priste me javë të tëra për një studim të gjatë nga figurat publike franceze mbi atë sesi mund t'i jepej fund luftës algjeriane që kishte dëmtuar unitetin kombëtar dhe reputacionin ndërkombëtar të Francës? Udhëheqja buron nga një arsye historike që ndonjë-

herë kërkon të priten Nyjet Gordiane, jo të mbetesh vetë lidhur në këto nyje.

Presidenti dhe lidhshipi politik i Amerikës, duhet të pranojnë se roli amerikan në botë është duke u minuar ashpërsisht nga politikat e nisura përpara 3 vjetësh. Lufta shkatërrimtare në Irak, indiferenca hipokrite ndaj dimensionit human të marrëdhënieve të bllokuara izraelito-palestineze, mungesa e iniciativës diplomatike në marrëdhëniet me Iranin dhe përdorimi i shpeshtë i retorikës islamofobike, janë duke vene në lëvizje forcat të cilat kërcënojnë ta nxjerrin jashtë Amerikën nga Lindja e Mesme, me pasojë të tmerrshme për atë vetë dhe për miqtë e saj në Egjipt, Izrael, Jordani dhe Arabinë Saudite.

Amerika natyrisht ka nevojë për një ndryshim strategjik, dhe ky duhet të ndërmerret në një front të gjerë. Ai duhet të pranojë faktin që lidhshipi real në Irak duhet të jetë mbështetur mbi një koalicion të klerit shiit që komandon milicinë luajale shiite dhe kurdëve autonomë dhe që sa më shpejtë të fiksohet një datë për tërheqjen amerikane, aq më shpejtë liderët e vërtetë irakien do të jenë në gjendje të rekrutojnë fqinjët e Irakut në një përpjekje të gjerë rajonale për të ndihmuar një Irak më të qëndrueshëm.

Kjo duhet gjithashtu të angazhojë aleatët e saj në një përcaktim të përbashkët të parametrave bazë të një marrëveshjeje izraelito-palestineze, meqenëse të dyja palët në konflikt nuk do të arrijnë kurrë që ta bëjnë vetë këtë. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, SHBA duhet të jetë e gatshme të vazhdojë bisedime multilaterale dhe bilaterale me Iranin, përfshi edhe çështjet e sigurisë rajonale.

Shkurt, dilema imediate është Iraku, por sfida me e madhe është e ardhmja e Lindjes së Mesme.

Zbigniew Brzezinski-Ish-Këshilltar për Çështjet e Sigurisë Kombëtare të Presidentit Xhimi Karter ("THE FINANCIAL TIMES").

Lexim i tekstit

TEKSTI I THURUR SI NJË LABIRINTH SEMIOTIK

Osman Gashi, “Përtej Harresës”, Shtëpia Botuese Rozafa, Prishtinë.

Duke pasur parasysh figuracionin e tekstit, e sidomos metaforat të shënuara në shtresën tekstore, autori në të shumtën e kohës, shkruan e dëshmon para tjetrit emocionet e veta. Tekstit i mjafton të jetë figurë, ndërsa idetë shprehen së bashku me emocionalitetin autorial.

Flamur MALOKU

Diskurset poetike të Osman Gashit, në vëllimin poetik “Përtej Harresës”, botuar më 1999, nga Shtëpia Botuese Rozafa, ecin në mënyrë lineare së bashku me poezinë bashkëkohore shqiptare, prandaj ky vëllim është bërë pjesë e pandashme e poezisë sonë letrare.

Mirëpo ajo çka e veçon këtë vepër poetike është se diskursi ligjërues i autorit funksionon si sistem metaforik.

Edhe pse poezitë janë të ndara në tri cikle: “Alkimi i dhembjes”, “Hap urithi”, “Vera që s’kthen”, diskursi tejet metaforik ofrohet nëpërmjet koncepteve ideore të shprehura nga poeti. Prandaj, për t’u arritur kjo, do të veçojmë disa poezi karakteristike të autorit.

Duke filluar nga poezia “Mos më harro”, i tërë teksti poetik shënjon një lutje të drejtpërdrejtë të autorit. Në këtë rast, subjekti ligjëron me shenja të gjakimit personal, duke krijuar një besueshmëri para lexuesit, në radhë të parë, për ta besuar vetë autori, se ky mall është i madh, dhe në radhë të dytë për t’ia paraqitur lexuesit këtë mall:

Ti je shumë larg nga unë
Dhe nga kjo ditë e zymtë
(Mos më harro)

Duke pasur parasysh figuracionin e tekstit, e sidomos metaforat të shënuara në shtresën tekstore, autori në të shumtën e kohës, shkruan e dëshmon para tjetrit emocionet e veta. Tekstit i mjafton të jetë figurë, ndërsa idetë shprehen së bashku me emocionalitetin autorial. Nëpër këtë vijë thuret edhe teksti “Burg”, që duhet të lexohet e të interpretohet, çdo herë duke i marrë figurat përshkruese, të cilat konsiderohen si rezultat i një momenti autorial. Kjo poezi fillon me një përjetim konkret, apo më mirë të themi nga një situatë konkrete, që emocionin bartet në

figurë, për t’u rikthyer kah përjetimi e në situatë. Kështu për të përforcuar tekstin, autori i referohet figurave, që në esencë përpu-then me vetë idetë e tekstit : Shpendkeqja, Kukurvajka, etj. Refreni i përsëritur në fillim dhe në fund, të sjellë në mend edhe statusin e tekstit: poezi e gjakimit. Nuk duhet harruar se teksti është shkruar në një kohë në të cilën jeton edhe subjekti.

Në tekst koha është e zymtë, që në dijen e autorit bëhet terr, ndërsa terri shënjon lemerinë, dhembjen, vuajtjen e autorit, duke iu përshtatur edhe sintagma burg:

Është terr
Burg
(Burg)

Përmes këtij meditacioni thuret poezia “Një det i thellë”, ku teksti fund e krye përcillet me një emocionalitet të dhembshëm e trishtues.

Një lumë vështroi shpresat e mia
një bjeshkë ma ndrydhi gëzimin
fëmijëror
(Një det i thellë)

Në këtë rast, teksti njëherësh formon edhe skemën:

Autori Figura Emocioni.

Derisa emocionet shpërthejnë në shtresën tekstore, idetë autoriale dalin të shprehura me emocionin, duke u ndërlidhur me figuracionin. Pra edhe ky tekst shënjon dhembjen autoriale përballë kohës reale:

Dhembjen time dikush
E nxu me brushë të zezë
(një det i thellë)

Ndërsa poezia “Fund” që e përmbyll tekstin poetik shënjon fundin e botës, një ide që shprehet në librat fetarë: në Kur’an dhe në Bibël. Mirëpo në paraqitjen e fundit të botës, autori sikur do të thotë se askush nuk mund të shpëtojë nga ky fund, dhe se çdo gjë do të ndryshohet. Andaj teksti thuret si një labirint semiotik. Duke pasur parasysh këto që u cekën më lart, shihet se Osman Gashi shpreh ide të papara që në esencë kërkojnë 'lexuesin model' siç thotë Eco, kështu poezitë e Osman Gashit konotojnë ide të shumta semiotike.




Botime librash

VITRINA

Berat DAKAJ

Libri “Shqipëria Natyrale”, i autorit Koço Danaj, është i përbërë nga trajtesa të ndryshme të cilat janë të orientuara mbi çështjen e kombit shqiptar, gjegjësisht, epiqendër e shumë trajtesave të këtij libri është Shqipëria dhe fqinjët e saj të identitetit shqiptar. Koço Danaj në këtë libër ka dhënë një vështrim rreth të bërit të Shqipërisë Natyrale. Brenda librit jepen edhe disa mundësi për integrimin




brendashqiptar dhe integrimin në strukturat e tjera, deri në BE. Vitin e mbrapshtë e sheh atë të egërsuarin në vitin 1913, kurse vitin e mbarë që do t'i jepte ngjyrë një Shqipërie të bashkuar e sheh vitin 2013, kur edhe mendon se do t'i jepen fund një vargu problemesh të shpeshta dhe të pazgjidhshme ende për shqiptarët. Libri ka edhe tri parathënie nga autorët: Aleksandër Cipes, Frrok Çupi, dhe Arsim Sinani.

Libri ka 120 faqe. Botoi Shtëpia Botuese Erik, Tiranë 2006

Poeti që po e tregon veten të veçantë në poezinë bashkëkohore shqipe, është edhe autori i “Burimi nën gjuhë”, Basri Çapriqi.

Poezitë e këtij teksti janë zgjedhur dhe përzgjedhur nga poeti Ali Podrimja. Në të 11 ciklet janë trajtuar krejtësisht poezi me temë erotike, mendimtare, poezi përshkruese, dhe disa proza të shkurtra poetike, në të cilat janë përdorur llojllojshmëri figurash stilistike. Poezitë e tij përshkohen edhe nga tema sociale, atdhetare, një atdhetarizëm që shikon më një sy gjykues ndaj krerëve të shtetit.



Stili i Çapriqit në këto poezi kërkon të flasë me lexuesit model.

Tekstet i paraprin edhe parathënie e Ali Podrimës, i cili në mënyrë përmbledhëse ka dhënë informacione mbi disa nga poezitë e përzgjedhura të Basriut.

Vepra ka 240 faqe. Botoi Shtëpia Botuese Toena, Tiranë 2005



Libri “Fshehtësia e një martese të lumtur”, i autores Ruqayyah Waris Maqsood, thyen disa tabu të cilat lidhen më fshehtësitë e raportit burrë-grua në Islam. Ajo depërton në prapaskenën muslimane, dhe shembull fillues të një raporti bashkëshortor e merr veten dhe burrin e vet. Pas një vërtetësie mbi të lejueshmet seksuale, Maqsood, çdoherë argumentin e gjen në librin e shenjtë. Përqendrimi i autores rreth martesës në Islam dhe marrëdhëniet seksuale të pranueshme dhe refuzuese janë të

argumentuara përmes ajeteve të Kur'anit dhe Hadithit. Njëra prej detyrave të tjera shtesë për muslimanin në këtë libër e shohim të jetë edhe martesë, një martesë e ligjshme, e lumtur.


Autorja e këtij libri ka botuar rreth dyzetë libra me tema të ndryshme rreth njeriut islam dhe botës islamike.

Libri ka 224 faqe. Është përkthyer nga gjuha boshnjake nga Liridona Adili. Botues Klubi Studentor, Shkup 2006.

Letërsisë artistike shqiptare vazhdimisht është duke i kontribuar më të madhe edhe shkrimtari Kasëm Trebeshina. Veprimtaria e tij e gjerë tashmë kalon mbi 140 vepra të formave, gjinive dhe zhanreve të ndryshme. Ai, letërsisë shqipe, ia ofroi edhe veprën “Tregtari i skeleteve”, në të cilën ndërthurën një mori motivesh që lidhen më veprimet e misionarit të intelektualit klasor, Asmut Rrakatakja.

Rrakatakja është misionari i një fushate të gjerë dhe të gjatë. I ka vënë vetes një detyrë të mundimshme në misionin e vet politik, pikërisht mbledhjen e skeleteve. Kryerja e misionit e simbolizon njeriun fitues. Mbledh eshtrat prej njërit skaj në tjetrin dhe shpesh, shumë nga skeletet mbetën të panumërueshëm.

Për këtë roman autori ka marrë çmimin e parë në konkursin e tretë të hapur nga




Shtëpia Botuese Buzuku.

Romani ka 20 kapituj të përfshirë në 246 faqe. Botoi Shtëpia Botuese Buzuku, Prishtinë 2006.

Letërsi

POEZI

Vesel ISLAMI



GJEJ RRUGËN E DREJTË

Nëse ke rënë në gjumë
Zgjimi të pret
Nëse kërrusesh përtokë
Duhet të ngrihesh lart
Nëse lëviz vetëm lart
Dije se të pret rënia
Nëse shkon nga e majta
Djathtas mbrohu
Nëse ecën vetëm para
S'ke ç'të shikosh mbrapa

ODIESEJADË

Zemra e heshtur bluan
Harresën e gjelbër
Shpirti i etur kërkon fluturim
Shushuritja e dallgëve
Zgjon një mendim
Se kali i Trojës lundron në gjak
Nga vjen ky rënkim
Niset anija lundruese
Që botën bart në vete
Në një hapësirë pa kthim
E brenga njerëzore shtohet
Në vazhdim

PAK DRITË

Pak dritë në botë
Që ta shohim qiellin e kaltër
E ta njohim njëri-tjetrin
Pak dritë në botë
Të humbet pikëllimi e mërzia
Gjelbërimi të vazhdojë
Pak dritë të na mbulojë
O vetëm pak dritë
Ta njohim njëri-tjetrin
Pak dritë.

MËRZI

Brenda katër mureve
I vetmuar qëndroj
Asgjë s'lëviz
Madje as ajri
Me duket se jo
E heshtja flet me vetvete
Dëgjoj vetëm
Tik- taket e orës
Ato që ma numërojnë
Kohën
E heshtja flet me vetvete
Por, nuk dëgjohet
Askush s'e di!

UNË E TI

Për çdo ditë
Harrohemi
Nga pak rritemi
Nga pak zvogëlohemi
Unë e ti
Për çdo ditë
Më afër vdekjes
Më pranë Zotit
Prandaj të jemi pa lot në sy
Unë e ti
Për çdo ditë
Nga një pjesë e zemrës vdes
Nga një pjesë e zemrës lind
Mos harro
Jemi pranë Zotit
Vetëm të jemi në rrugë të drejtë
Unë e ti

VDEKJA

Jeta ecën drejt vdekjes
Vdekja nuk i ikën jetës
Para shtrihet horizonti i gjerë
Rrethi nga 360 shkallë
Ngushtohet ditë e më shumë
Ku vemi nuk e di
E jeta kacafytet me vdekjen
Ke hyrë në labirintin e saj
Kërko shpëtimin e Zotit
Lutu për pak qetësi
Përgjerohu
Por, shpëtim nuk ka.

MORFOLOGJIA E KOKËS SË POPULLATËS SHQIPTARE TË KOSOVËS

Në përgjithësi të dhënat morfologjike të kokës nga ky punim, përputhen me të dhënat e autorëve tjerë, të cilët gjetën ngjashmëri ndërmjet tipareve morfologjike të tipit dinarik (Ilirik) të njeriut dhe popullatës shqiptare.

Agron REXHEPI


Hulumtimi i tipareve antropologjike të një populli, kërkon mbledhjen e informatave të bollshme nga hapësira të ndryshme të statusit antropologjik, si nga hapësira morfologjike, fiziologjike, biokimike, motorike, sociale, kognitive, konative, gjenetike, ekologjike, lingvistike, etnografike etj.

Të dhënat e fituara nga matjet e kokës kanë rëndësi prioritare në hulumtimet antropologjike, pasi që janë të vetmet që mundësojnë një studim të statusit antropologjik të popujve, në kuptimin kronologjik dhe mundësojnë krahasimin e vetive antropologjike të popujve të sotëm dhe popujve të më hershëm.

Botës shkencore i intereson tipi morfologjik i shqiptarëve për arsye se shqip-

tarët janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të ilirëve, të cilët në Evropën e vjetër zinin një hapësirë të madhe, dhe se territoret shqiptare i përkasin bërthamës qendrore të tipit dinarik, njërit nga tipat antropologjikë themelorë të popullive evropiane. Tipi dinarik i njeriut njihet edhe me emrin: tipi Ilirik, ndërsa karakterizohet me shtatë të lartë, trup të hollë e muskolor, kockëzim të fortë, krahë të gjerë, gjoks të zhvilluar, gjymtyrë proporcionalisht të zhvilluara me madhësi mesatare, kokë të gjatë dhe të gjerë, fytyrë të zgjatur, ndërsa indeksi kranial tregon se koka i takon tipit brakicefalik.

Me qëllim të hulumtimit të morfologjisë së kokës së popullatës kosovare në Institutin e Antropologjisë Sportive në



Prishtinë kemi bërë matjet e kokës në 754 entitete, të moshës 23 - 55 vjeçare (561 meshkuj dhe 193 femra). Entitetet i kanë takuar popullatës shqiptare kosovare, zgjedhja e tyre ka qenë e rastit, ndërkaq, kriteri i zgjedhjes ka qenë që gjendja psiko-fizike: të jetë normale, pa deformime të kokës dhe fytyrës, si dhe të kenë dhëmbë natyralë dhe formë normale të tyre. Matjet janë bërë në periudhën kohore 1997 - 2002. Matjet janë bërë me instrumente klasike antropometrike, sipas udhëzimeve dhe kriterëve të Programit Biologjik Ndërkombëtar dhe të praktikumit të antropologjisë biologjike.

Në tabelat e mëposhtme është paraqitur kategorizimi dhe shpërndarja e vlerave (në numër dhe në përqindje) të matjeve të gjatësisë dhe gjerësisë së kokës sipas shkallës Lebzelter-Saller, të lartësisë së kokës sipas shkallës Routil dhe indeksit cefalik sipas shkallës Martin-Saller.

Shih tabelën nr. 1: Klasifikimi i entiteteve të matura në bazë të dimensioneve të kokës

Kategorizimi i kokës në bazë të gjatësisë së kokës tregon se pjesa dërmuese e entiteteve të gjinisë mashkullore (50.1%) përqendrohet në kategorinë me kokë të gjatë, pjesa tjetër është e shpërndarë më tepër në kategorinë me kokë mesatarisht të gjatë (26%) dhe diçka më pak në kategorinë me kokë shumë të gjatë (20.3%).

GJATËSIA E KOKËS	Lebzelter-Saller	Meshkujt		Femrat	
Koka shumë e shkurtër	> 169	1	0.20%	7	3.60%
Koka e shkurtër	170 - 177	19	3.40%	54	28.00%
Koka e mesme	178 - 185	146	26%	97	50.30%
Koka e gjatë	186 - 193	281	50.10%	33	17.10%
Koka shumë e gjatë	194 <	114	20.30%	2	1.00%
GJERËSIA E KOKËS	Lebzelter-Saller	Meshkujt		Femrat	
Koka shumë e ngushtë	> 139	5	0.90%	1	0.50%
Koka e ngushtë	140 - 147	14	2.50%	38	19.70%
Koka e mesme	148 - 155	178	31.70%	98	50.80%
Koka e gjerë	156 - 163	279	49.70%	50	25.90%
Koka shumë e gjerë	164 <	85	15.20%	6	3.10%
LARTËSIA E KOKËS	Routil	Meshkujt		Femrat	
Shumë e ultë	< 109	29	5.20%	46	23.80%
E ultë	110 - 117	129	23%	79	41%
Mesatare e lartë	118 - 125	258	46.00%	59	30.60%
E lartë	126 - 133	115	20.50%	8	4.10%
Shumë e lartë	134 <	30	5.30%	1	0.50%

INDEKSI CEFALIK	Martin-Saller	Meshkujt		Femrat	
Dolicocefal	< 75.9	13	2.30%	1	0.50%
Mezocefal	76.0 – 80.9	110	19.60%	31	16.10%
Brakicefal	81.0 – 85.9	291	51.90%	84	43.50%
hiperbrakicefal	86.0 – 90.9	140	25%	68	35.20%
ultrabrakicefal	91 <	7	1.20%	9	4.70%

Ndërkaq, entitetet e gjinisë femërore karakterizohen kryesisht me kokë të mesme (50.3%) në të shkurtër (28%); Një shpërndarje e ngjashme e popullatës haset edhe te gjerësia e kokës, ku 49.7% e popullatës radhitet në grupin me kokë të gjerë, 31.7% e popullatës është radhitur në grupin e popullatës me kokë mesatarisht të gjerë, ndërsa 15.2% e popullatës është radhitur në grupin me kokë shumë të gjerë.

Kategorizimi i femrave sipas gjerësisë së kokës bëhet si vijon: 50.8% me kokë mesatarisht të gjerë, 25.9% me kokë të gjerë dhe 19.7% me kokë të ngushtë 19.7%;

Me kokë mesatarisht të lartë karakterizohen 46% të meshkujve të matur, përderisa me kokë të ultë 23% dhe të lartë 20.5%. Për dallim nga meshkujt, 41% të femrave karakterizohen me kokë të ultë, 30.6% me kokë mesatarisht të lartë dhe 23.8% me kokë shumë të ultë;

Shih tabelën nr. 2


Vlerat e indeksit të kokës së meshkujve të matur (raporti i gjerësisë së kokës dhe i gjatësisë së kokës) tregojnë se 51.9% të popullatës së hulumtuar i takojnë grupit brakicefalik, 25% grupit hiperbrakicefalik dhe 19.6% grupit mezocefalik. Edhe te femrat vërehet një shpërndarje e

ngjashme e indeksit cefalik: 43.5% kokë brakicefalike, 35.2% kokë hiperbrakicefalike dhe 16.1% kokë mezocefalike;

Pas analizës së tabelave të mësipërme mund të konstatohet se entiteti mashkull i mostrës së matur ka një morfologji të kokës që karakterizohet me dimensionin cefalik të shprehur (kokë të gjatë, të gjerë dhe mesatarisht të lartë), përderisa entiteti femër i mostrës së matur karakterizohet me dimensionin cefalik mesatarisht të shprehur (kokë mesatarisht të gjatë dhe të gjerë, e ultë deri në mesatarisht e lartë). Indeksi cefalik tregon se entitetet e të dy gjinive karakterizohen me kokë brakicefalike.

E vërteta është se tipat morfologjik të popullatës së sotme nuk mund të veçohen lehtë, sepse ndërmjet tipave të ndryshëm, hasim tipat me tipare ndërmjetëse.

Mirëpo, në përgjithësi të dhënat morfologjike të kokës nga ky punim, përputhen me të dhënat e autorëve tjerë, të cilët gjetën ngjashmëri ndërmjet tipareve morfologjike të tipit dinarik (Ilirik) të njeriut dhe popullatës shqiptare.



Copyright Williams & Wilkins, Grant's Atlas of Anatomy

LAJME NGA TEKNOLOGJIA

Shkelzen NUZA

Pajisjet që erdhën gjatë vitit 2006 ishte përtëritëse të produkteve të mëhershme, por jo që të gjitha ishin të kënaqshme dhe disa punonin pjesërisht. Këtu po japim një listë të shkurtër të produkteve:

RIM BlackBerry Pearl: Është telefon i cili ofron cilësi të lartë të teksteve dhe është shumë më i saktë se sa shumica e sistemeve T9, të provuara deri më tani. Pearl nuk shkakton probleme në shkuarjen e e-mailave sepse disponon një tastaturë të vogël.



TIPARET

Tipi	BlackBerry
Kamerë digjitale	Po

TIPARET E KAMERËS DIGJITALE

Megapixel-ët	1.3 Megapixel
Flash Type	Built-in flash

INFO TË PËRGJITHSHME

Lartësia	4.2 inç
Gjerësia	2 inç
Trashësia	0.6 inç
Pesha	0.0907 kg



TV Plasma

Përshkrimi i Prodhuesit

Ky televizion plasma 50 inçësh me 1080 pixel high-definition, dyfishon numrin e pixelave për të njëjtën hapësirë prej 50 inç, në mënyrë që të ofrojë pamje jashtëzakonisht të detajuar në ekran. Duke e ndërthurur përparësitë e 1080p dhe 720, ky rezolucion lejon një pamje shumë të pastër aty ku ka lëvizje shumë të shpejta, siç janë filmat aksion dhe sportet.

Nintendo Wii: Është shumë i përshtatshëm nëse planifikoni të zhvilloni lojëra grupore, siç është rasti me Rayman Raving Rabbids dhe Wii

Karakteristikat

TIPARET E DISPLAY-IT

Diagonalja	50 inç
Seritë	Elite PureVision
HDTV Compatible	Po
Rezolucioni	1080 p
Proporcioni i Pamjes	16:9
Proporcioni i Kontrastit	3000:1
Shkëlqimi	1000 cd/m ²
Rezolucioni i Display -it	1920 x 1080

PAJISE SHITESË

Remote Control	Remote control
----------------	----------------

INFO TË PËRGJITHSHME

Nënkategori	Plasma TV
Teknologjia	Plasma (PDP)
Tipi	Plasma panel
Pesha	39.8 kg
Gjithashtu dihen edhe	Pioneer

sportet.

Jamo i300 iPod Speaker System: I ngjashëm me Klipsch iFi, Jamo i300 është një prej iPod speaker dock-ve më të mirë që kanë qenë ndonjëherë. Ky iPod dock është mjaft i fuqishëm për një zyre



INFO TË PËRGJITHSHME

Platforma	Wii
Wireless Tipi	Wi-Fi
HDMI	Jo
Memoria e instaluar Memory	512 MB

Procesori	PowerPC
Game Media	Nintendo GAMECUBE disc
Slotat	Nintendo GameCube Memory Card, SD Memory Card
Memory Card	512 MB
Controller	Remote control, Joystick
Tiparet e Kontrolluesit	Motion sensor
Tipat e Konektorëve	2 x USB 2.0, 4 x game controller, Component video output, Composite video output, S-Video output

mesatare për nga madhësia. Ky mund ta zëvendësojë stereo-n tuaj në dhomën e gjumit.



INFO TË PËRGJITHSHME

Tipi i pajisjes shtesë	Docking station / speaker system
iPod Kompatibiliteti	iPod

Panasonic ToughBook 74: Ky është laptop shumë i fuqishëm, i cili ka rezistencë speciale, hyrje të plumbosura dhe bartet lehtë. Më e mira e këtij laptopi është i përshtatshëm për EVDO mundësi, që domethënë se ju mund të merrni online sinjale telefonike kudo. Për momentin kjo është e zhvilluar në SHBA.



CPU DHE MEMORIA

Prodhuesi	Intel
Shpejtësia e Procesorit	2 GHz Core Duo
Teknologjia	Intel Centrino Duo
Memoria e inat.&max	4 GB

AFORIZMI I MUAJIT

**TALENTI KRIJOHET NË VETMI,
KARAKTERI NË SHOQËRI.**

GËTE

Vijon

**TOP TELEFONAT E VITIT
2006**

Vitin e kaluar kemi pasur mundësi të shohim llojllojshmëri të gjërë të telefonave të rinj, të cilët kanë pushtuar tregun, duke filluar nga ata më të thjeshtë, deri te ata më mahnitës. Përgjatë vitit 2006 telefonat mobilë për muzikë dhe fotografi ishin shumë të mëdhenj, gjenerata 3G vazhdoi profilizimin e këtyre telefonave, duke futur bluetooth in dhe gjetjen e mënyrës së komunikimit me të. Gjithashtu, sa i përket trashësisë Motorola mbetet në trend e pathyeshme, e cila nuk do të sfidohet. Kështu që në javët e ardhshme do të dalin në treg telefonat më të mirë të deritanishëm. GSM Nokia 5300 e ç'bllokuar dhe GSM Sony Ericsson K790a janë ata që i prijnë listës së telefonave mobilë. 5300 është zgjedhja e duhur për muzikë, kurse K790 është zgjedhja e duhur për kamerë. Sony Ericsson W810i, në mënyrë elegante kombinon playerin e muzikës me telefon, përderisa LG VX8300 ofron performanca te larta për versionin e shfrytëzuesve. LG ka edhe një telefon tjetër ndër më të mirët e vitit 2006 që është CU500 për shfrytëzim edhe të wireless it; ky mbetet telefoni me bartësin më të mirë të gjeneratës së tretë të telefonave mobil (3G). Përfundimisht, Nextel Motorola i580 është telefoni më i qëndrueshëm, krahasuar me të gjithë telefonat tjerë.



Telefonat	Nokia 5300 Xpress Music (Red)	Sony Ericsson K790a	Sony Ericsson W810i	LG VX8300	LG CU500	Nextel Motorola i580
Specifikat themelore:						
Pesha	115 g	127.5 g	108.9 g	121 g	115 g	5.1 oz
Lartësia	3.6 inç	4.1 inç	3.9 inç	3.5 inç	3.8 inç	3.7 in
Teknologjia celulare	Nuk ka	GSM	GSM	CDMA2000 1X	WCDMA / GSM	IDEN
Brezi	Nuk ka	GSM 850/1800/1900 (Tri-Band)	GSM 850/900/1800/1900 (Quadband)	CDMA2000 1X 1900/800	WCDMA / GSM 850/900/1800/1900	IDEN 800/900 (Dual Ban)
Wireless Interface	Nuk ka	Bluetooth, Infrared (IrDA)	Bluetooth, Infrared (IrDA)	Bluetooth	Bluetooth	Bluetooth

Ilir DESKU

KOPORPORATA E KEK-UT

Çka i ka thënë A-ja B-së
Me ka ra të nxehtit kresë
Me pushu' pak a po dalim
Rrymën tash po e ndalim

Edhe C-ja po ankohet
Vetëm hiq nuk po punohet
Nuk e di a ta la këtë punë
Reduktime do të këtë më shumë

C-ja, B-ja edhe A-ja
Tri termocentralet e mëdhaja
A punojnë a nuk punojnë
Që shtatë vjet s'po e kuptojmë

Sa shumë para u harxhuan
U rinovuan a s'u rinovuan
Nuk din kush me të dhanë
shpjegime
Veç kur kemi reduktime

Nuk e di si po veprojnë
Dy orë rrymë nuk mjaftojnë
Por kot e kam edhe unë
zor është me i marr vesh këto punë

Se shqiptarët kështu janë
mësu'
Ditë e nate n'terr me i kalu'

NJË JËTË KOSOVARÇE

Mora lapsin bashkë me letër
Për me i shkru' nja dy fjali
Me bo dert e me kallxu'
Se këtu të na gjithëka bën vaki

Zor është bo' sot me jetu
E zor po e ka edhe ky millet
Kot mundohesh me qenë i drejtë
Po s'ka drejtësi me këtë hyqymet

Deri sa i morën votat
Ata t'gjithë jepshin premtime
Po kur erdhën në pushtet
Këto punë mbetën veç n'kujtme

Marr gazetën me e lexu
E nuk di as ku t'ia nis
Se të gjitha faqët e gazetës
Janë të mbushura me anëtarë të qeverisë

Njëri thonë se ka vjedh tender
E ky tjetri ministri
Po të gjithë janë të një rangu
Me u korruptu' hiq se kanë mërzë

Po me qyrr holl këta nuk kanë faj
Se UNMIKU kështu po i mëson
I ka bo të gjithë për vete
E për popull askush s'mendon

S'e dinë mirë as alfabetin
E m'shitën si shumë kapadai
Ju ka hy n'palcë korrupsioni
Krejt KOSOVËN n'xhep dojnë me e shti

Se pas lufte tollovi po shkon
Veç a ki ndopak njoftësi
nuk të duhet as një ditë shkolle
fill do të futin n'ministri

nese e din mirë alfabetin
e 2 + 3 me i mbledh
hiq pa gajle ha e pi
se ministër kanë me t'zgjedh

kishe na po lypim pavarësi
e edhe një njohje
nderkombëtare
na e coptuan vëndin krejte
tuj bo' ndarje territoriale

edhe kta t'KEK-ut e energjetikës
për çdo ditë ata ankohen
nga 4 milion çdo vit i marrin
e thonë para hiq s'po tubohen

Sot thonë A-ja ra prej sistemi
e nesër B-ja po ashtu
kanë harru se me 4 milion
një termocentral i ri tash ish ndertu

e nese flasim për shendetsi
zorrët n'bark kanë me u shqetsu
nese shkon me bo' kontrollë
fill privat thonë duhet me shku'


e nese shkon të ndonjë privat
t'ban kontroll sa për sy e faqe
n'vend që të shëron ai krejt ty
t'smun'

e ta mbush një kerr me ilaçe
harruan se para 7 vjete
ne të shkretit se ku ishim
s'kishim rroba e as bukë
e s'kishim ku as ujë të pijshim

turp të keni o pushtetar
ju që vendit po i prini
ju që vendin po e ndani
ju që gjakun po e shkilni

ju që s'keni fije turpi
ju që mall as ndjenja s'keni
ju të mjeret o politikaj
ju që veti vend kund spo i lini

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
1														
2														
3														
4														
5														
6														
7														
8														
9														
10														
11														
12														
13														
14														
15														
16														
17														
18														
19														
20														



HORIZONTALISHT

1. Terra-Rezistencë-I qëndrueshëm-Matematikan persian Khayam, foto (sh.). 2. Ushqim i preferuar turk-Iodin. 3. Tortat-Numri kuantik magnetik. 4. Vend në Kirgistan-Shkurtesë për (Education review Office)-Litër-Mal në Shqipëri. 5. Institute For Advanced Study-Nusja e djalit-Akronim për Musical Instrument Digital Interface. 6. Emër mashkulli-Mjet i rëndë tingëllues (sh.). 7. Radhë, varg-Një lloj zëri abnormal i mushkërive që dëgjohet me stetoskop. 8. Thirrje që u bëhet të tjerëve për të kërkuar përkrahjen dhe ndihmën e tyre në një çështje-zanore jona-Itali (shkurt). 9. Parti politike në Shqipëri-ulu (ang.). 10. Organizata e Kombeve të Bashkuara-Njësi (ang.). 11. Finacial Times-zanorja e parë - ... Lukreci (sh.). 12. Luan (ang.)-Filloj. 13. Oksigjen-Simboli kimik i Florit-Ishull në Francë që ka dalje në oqeanin Atlantik-Numër një romak. 14. Që ka të bëjë me procesin e fillimit (origjinës)-Qytet në Brazil (... de Janeiro). 15. Shkurtesë për Alternative Education Resource Organization-Pjesëtar i një grupi të madh popullsisht, që banojnë në disa vende të Azisë së Afërme dhe të Afrikës së Veriut- Muzeu i artit në Universitetin e Floridës. 16. Emër mashkulli ekspeditë gjuetie. 17. Shkurtesë për American Booksellers Association-"Artist i merituar" shqiptar, Capo-Emër femre. 18. Uran-Teuta Kurti-Pije që nxirret nga kokrrat e dëllinjës dhe që përdoret për të shuar etjen shkoj. 19. Nikel-Emër mashkulli-Shok (fr.). 20. Atom-Specialitet i kuzhinës kosovare-Grup etnik që jeton në Indinë Jugore dhe Sri Lankë veri-lindore.

VERTIKALISHT

1. Përemër vetor-Oksigjen-Profeti i parafundit-Bota bimorre dhe bota shtazore. 2. I Gjithëmëshirëshmi-shkurtesë për Independent Economic Advisory Board-Zanore. 3. Kornizë-Pikturë që bëhet më bojëra uji mbi suva të njomë-Nxjerrja e një malli në treg për ta shitur (sh.)-Një bashkëtingëllore. 4. Vajza e djalit-Republikë në bregun lindor në jugperëndim të Detit Mesdhe-sh.o.j-Kalium-Amerika. 5. Lumë në Mitrovçë-Nitrogen-Operating System-prapashtesa e faqeve zyrtare të internetit për Brunei. 6 I malit-Shkon anash. 7. U.j.s-Elena Kadare-Konstante e gazit-Enë e thellë dhe e rrumbullakët (sh.). 8. Emër Femre (sh.)-Provincë në Arabinë Saudite. 9. LL.R.-Paradite (ang.)-Emër femre. 10.Dhomat-Bor-Forcë-Internacional (shkurt). 11. Ata që marrin mitot-Radius-Derr i patredhur që mbahet për ndërzim, hakoç-Grup i gjakut. 12. Zanozja e parë-Mjet eksplozues-Rrugëtimi-Americium. 13. Modaliteti i sërishëm-Ngaemimi. 14. Zanore-Ceremoni fetare (sh.)-Detyrë e përkohshme me përgjegjësi, që i ngarkohet dikujt-Hero i Grekëve.